



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 352 Akti

Nr. 371 Vendimi
Tiranë, më 22.4.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

| | |
|--------------------------|-----------|
| Firdes Shuli | Kryesuese |
| Brunilda Bekteshi | Relatore |
| Pamela Qirko | Anëtare |

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 20.04.2021, ora 10:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Besjana Garxenaj**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998”;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Brunilda Bekteshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shpresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Besjana Garxenaj, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).
2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGj).
3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka zhvilluar shortin në datën 12.11.2019, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit, znj. Besjana Garxenaj, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Brunilda Bekteshi dhe Pamela Qirko. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Brunilda Bekteshi.
4. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 2.12.2019, të trupit gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Besjana Garxenaj, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Alma Faskaj. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
5. Në datën 4.12.2019, subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, në datën 18.4.2019, deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit. Në datën 23.4.2020, me vendimin nr. 18, datë 9.3.2020, të Komisionit, komisionerja Alma Faskaj është zëvendësuar nga komisionerja Firdes Shuli. Subjekti i rivlerësimit u njoftua për këtë zëvendësim dhe njëkohësisht iu kërkua deklarimi i konfliktit të interesit për anëtarin e ri të trupit gjykues. Në datën 30.4.2020, subjekti deklaroi se nuk ka konflikt interesi me anëtarin zëvendësues të trupit gjykues.
6. Në datën 8.12.2020, përmes postës elektronike, subjekti ka paraqitur kërkesën me postë elektronike por edhe zyrtare nr. ***, datë 25.11.2019, përmes së cilës është parashtruar se: “...nuk jam subjekt i ligjit nr. 84/2016 ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve’, pasi e gjithë procedura e verifikimit deri në caktimin tim në pozicion është kryer nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në zbatim të nenit 160 të ligjit nr. 96/2016, ‘Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve’. Kjo kompetencë, e caktuar shprehimisht në dispozitat kalimtare ka rregulluar në mënyrë specifike statusin tonë (vetëm brezin tonë të magistratëve), sikurse i ushtron sot Këshilli i Lartë Gjyqësor. Konkretisht në nenin 160 të ligjit nr. 96/2016, ‘Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’, është përcaktuar se: ‘1. Deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe inspektoratet ekzistuese do të vazhdojnë të ushtrojnë kompetencat e mëposhtme, sipas rregullave të caktuara në këtë ligj: (a) emëron magistratët kandidatë të diplomuar në vitin 2016, në përputhje me pjesën III, kreu II, të këtij ligji, të paktën dy muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji; (b) merr vendim për caktimin në pozicion të kandidatëve magistratë të diplomuar në vitin 2016, sipas pjesës III, kreu III, të këtij ligji, brenda tre muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Në zbatim të dispozitës së sipërcituar Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka kryer verifikimet përkatëse për secilin prej magistratëve të diplomuar në vitin 2016, në përputhje me pjesën e III Kreu II dhe pjesën e III Kreu III të ligjit nr. 96/2016, duke u mbajtur edhe relacioni përkatës.

*Në datën 20.1.2017, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka vendosur emërimin 'Magjistrat', për secilin prej nesh me vendimet respektive, nr. 2; 3; 4; 5; 6; 7; 8 dhe 9, në përputhje me nenin 35/1 të ligjit, sipas së cilit: 'I diplomuari emërohet magjistrat nëse plotëson njëkohësisht këto kritere: (a) është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar, me të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme; (b) është vlerësuar minimalisht "mirë" për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar; (c) ka kaluar sërish verifikimin e pasurisë dhe figurës, të kryer nga Këshillat në përputhje me parashikimet në pikat 2 deri në 6, të nenit 32, të këtij ligji. Me vendimin nr. ***, datë 20.1.2017, unë jam emëruar 'Magjistrat'.*

*Në vijim, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 96/2016, me vendimin nr. ***, datë 10.2.2017, 'Për caktimin në pozicion të magistratëve që kanë përfunduar në periudhën tetor 2013 – qershor 2016 në Shkollën e Magjistraturës', ka vendosur caktimin tim në pozicionin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.*

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, duke zbatuar nenin 39, pika 5, të ligjit nr. 96/2016, duke qenë subjekte të këtij ligji ka marrë vendim për 'caktim në pozicion', në disa prej Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë, të disa prej magistratëve të diplomuar në vitin 2016. Ndërkohë, me parashikimet e mëparshme ligjore, nuk do të ishte i mundur caktimi në pozicion në Gjykatat Administrative, pasi asnjë prej nesh nuk plotësonte kriterin e caktuar në nenin 5, pika 2, e ligjit nr. 49/2012 'Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative' (5 vjet vjetërsi).

Theksoj se në datën kur ligji nr. 84/2016 ka hyrë në fuqi, unë nuk e kam pasur titullin 'gjyqtar', kjo referuar edhe vetë nenit 160 të ligjit nr. 96/2016, 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve', i cili na ka cilësuar në mënyrë të shprehur 'kandidatë për magistratë të diplomuar në vitin 2016' dhe jo gjyqtarë në detyrë. Ky rregullim ligjor ka qenë specifik, vetëm për brezin e magistratëve që kanë kryer Shkollën e Magjistraturës në periudhën tetor 2013 – qershor 2016, ku përfshihem edhe unë.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në të gjitha vendimmarrjet e tij ka referuar dispozitat e ligjit nr. 96/2016, pasi vetë ligji nr. 96/2016 në përmbajtjen e tij na ka cilësuar subjekt të tij dhe ka përcaktuar edhe procedurën që duhej të ndiqej, ku praktika dokumentare aktualisht ndodhet pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organ i reformuar dhe vijues i KLD-së.

Marrja në shqyrtim dhe kryerja sërish e procedurës, për marrjen e titullit 'Magjistrat', që parashikohet në ligjin nr. 96/2016, 'Për Statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve' do të cenonte parimin e 'sigurisë juridike' dhe parimin 'gjë e gjykuar'. Për analogji do të ishte e njëjta situatë nëse magistratët që aktualisht verifikohen dhe më pas marrin titullin "Magjistrat" e "Caktohen në pozicione" nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si subjekte të ligjit nr. 96/2016, të verifikohen edhe në kuadër të ligjit nr. 84/2016 nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, duke u bërë subjekt i dy ligjeve të ndryshme, në të njëjtën kohë.

Së fundi, duke qenë e gatshme për bashkëpunim dhe duke mos pasur asnjë arsye për t'ju shmangur procesit të rivlerësimit, nëse nga ana juaj do të konsiderohesha subjekt i ligjit nr. 84/2016, do t'ju lutesha që para përfundimit të afatit që më keni caktuar, të merrni një vendim në lidhje me kërkesën time.

Mbetem në pritje të qëndrimit tuaj, sikurse Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vepruar në raste të ngjashme, konkretisht: vendimi nr. 156, datë 12.6.2019; vendimi nr. 174, datë 1.7.2019; vendimi nr. 178, datë 8.7.2019; vendimi nr. 179, datë 10.7.2019; si dhe vendimi nr. 186, datë 23.7.2019”.

7. Komisioni, me e-mail-in e datës 30.4.2020, ka informuar subjektin se procesi i saj për momentin është i pezulluar, derisa të marrë në shqyrtim kërkesën e saj. Në datën 19.11.2020, pas shqyrtimit të kërkesës, Komisioni informoi subjektin se do të vijojë me hetimin administrativ, me arsyetimin e vendimit, si dhe do të njihet me vendimin përfundimtar të procesit të saj të rivlerësimit.

7.1 Lidhur me pretendimet e subjektit të parashtruar në kërkesën e saj se nuk është subjekt i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”, trupi gjykues arsyeton duke u bazuar në dispozitat ligjore kushtetuese dhe ato të ligjit nr. 84/2016: (i) ligji nr. 84/2016, në nenin 3/16, ka parashikuar shprehimisht: “*Subjekt i rivlerësimit janë të gjithë personat e parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës*”; (ii) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 179/b/3 dhe 5 të saj ka parashikuar: “*3. Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit ex officio.5. Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese. Gjatë periudhës kalimtare 9-vjeçare Gjykata Kushtetuese do të funksionojë me dy kolege.*”; (iii) mbi kërkesën e Komisionit, Shkolla e Magjistraturës me shkresën nr. *** prot., datë 23.12.2019, ka depozituar dokumentacionin e kërkuar. Ndër të tjera, në dokumentacionin e depozituar, rezulton si vijon:

- Me shkresën nr. ***prot., datë 24.11.2015, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, i ka njoftuar drejtuesit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, *Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 9326, datë 20.11.2015, me të cilin janë emëruar përkohësisht për të kryer stazhin profesional si “gjyqtar” në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, tetë kandidatët për magjistrat, të cilët kanë ndjekur magjistraturën për vitet 2013 – 2016. Në planin mësimor për vitin e III-të të Shkollës së Magjistraturës (periudha e stazhit profesional) është parashikuar se: (a) gjatë praktikës profesionale aktive të vitit të III-të të Shkollës së Magjistraturës, kandidatët marrin një emërim paraprak nga Presidenti i Republikës dhe kryejnë stazhin si gjyqtarë apo prokurorë; (b) po në këtë plan, në pikën 1 me titull “Objektivat e përgjithshme të programit për magjistratët e vitit të III-të”, ndër të tjera, është parashikuar se të emëruarit gjykojnë dhe hetojnë fillimisht çështje civile e penale të thjeshta, duke evoluar gradualisht drejt çështjeve më të vështira.*

- Në interpretim të dispozitave të cituara më sipër, personat objekt i këtij arsyetimi, në përfundim të arsimimit përkatës (për shkak se ishin diplomuar), në kuptim të nenit 160 të ligjit nr. 96/2016, kanë gëzuar titullin “magjistrat kandidat” deri në emërimin definitiv si magjistrat. Ndërsa, rivlerësimi i tyre lidhet ngushtësisht me statusin që kanë mbajtur përgjatë vitit 2016.

- Legjislacioni i sipërcituar në mënyrë kronologjike qartëson statusin që subjektet duhet të kenë në kuptim të përkufizimit “*subjekt rivlerësimi*”.

- Procesi i rivlerësimit përfshin në objektin e tij, *gjyqtarët*, që në këtë rast, subjekti, si një ndër tetë kandidatët për magjistrat, ka qenë emëruar si e tillë me Dekret të Presidentit në vitin 2016. Si gjyqtar të përkohshëm ata kanë ushtruar detyrën e tyre duke hetuar, gjykuar e dhënë vendime përgjatë vitit 2016, sigurisht edhe me pasoja për palët ndërgjyqëse.

Trupi gjykues, në referim të detyrimeve të sanksionuara nga dispozitat e Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, të aplikueshme prej momentit të hyrjes së këtij të fundit në fuqi, vë theksin te fakti që neni 179/b i Aneksit të Kushtetutës, në përcaktimin e subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio*, përfshin të gjithë gjyqtarët dhe kategoritë e tjera, pa bërë asnjë specifikim, ndarje në nënkategori apo dallim midis gjyqtarëve në detyrë dhe atyre jo në detyrë. Për sa kohë ky përkufizim i përfshin të gjithë gjyqtarët që gëzojnë këtë status “kandidat për magjistrat” - ndryshe nga sa parashtron subjekti, Komisioni nuk konstaton arsye për të cilat znj. Besjana Garxenaj nuk do të duhej t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit *ex officio*.

Gjithashtu, po vetë subjekti nën zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në ngarkim të subjekteve të rivlerësimit *ex officio*, në funksion të mundësimit të kryerjes, pikërisht, të këtij procesi ndaj tyre, ka përmbushur detyrimet e cituara shkurtimisht në dispozitat e mëposhtme: (a) ligji nr. 84/2016 lidhur me fillimin e procedurës së vlerësimit të pasurisë, në pikën 1, të nenit 31 parashikon: “*Subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon pranë ILDKPKI-së*”; (b) po ashtu, në pikën 1, të nenit 35, të ligjit 84/2016, lidhur me fillimin e procedurës për kontrollin e figurës, përcaktohet se: “*Subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën për 9 kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 bashkëngjitur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të tij dhe e dërgon atë pranë Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar*”; (c) ndërsa, në vijim, lidhur me fillimin e procedurës për vlerësimin e aftësisë profesionale, në pikën 1, të nenit 41, shprehet se: “*Subjekti i rivlerësimit plotëson formularin e vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 bashkëlidhur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale*”.

Në përfundim, trupi gjykues, për sa arsyeton më sipër, vlerëson se znj. Besjana Garxenaj në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ishte subjekt që duhej t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit *ex officio*.

8. Komisioni, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Besjana Garxenaj, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes, për të tria kriteret e rivlerësimit; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me rezultatet e hetimit kryesisht; (iii) të paraqesë pretendime/sqarime brenda afatit të caktuar; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative.

9. Në datën 30.3.2021, subjektit të rivlerësimit iu njoftuan rezultatet e hetimit, e cila në të njëjtën datë kërkoi riçeljen e hetimit administrativ, administrimin e të gjithë dokumentacionit përkatës, si dhe konfirmimin e afatit për dërgimin e shpjegimeve të saj mbi rezultatet e hetimit.

9.1 Mbi kërkesën e saj sipas pikës 9, Komisioni qartësoi subjektin se: (i) lidhur me afatin e caktuar, ishte mbajtur në konsideratë kërkesa e saj lidhur me informacionin që kërkohej të merrej nga DPSHTRR, në raport me tërësinë e barrës së provës për procesin e rivlerësimit; (ii) po në materialin e rezultateve, “faqe 4, footnote 9”, është cituar se: “*Kjo gjendje financiare është deri aktualisht. Vlerësimi final do të rezultojë pas prapësimeve të prezantuara nga subjekti mbi këto rezultate hetimi*”; si dhe (iii) pranoi dhe administroi dokumentacionin e dërguar prej saj, duke rikonfirmuar të njëjtin afat të caktuar në njoftimin e rezultateve të hetimit për dërgimin e shpjegimeve dhe provave.

10. Në datën 14.4.2021, me vendimin nr. 3, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Besjana Garxenaj, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, si dhe me anë të postës elektronike u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 20.4.2021, ora 10:30, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

11. Në datën 20.4.2021 u zhvillua seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm.

II. SEANCA DËGJIMORE

12. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Besjana Garxenaj, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi. Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit, shprehu qëndrimin e saj lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni.

13. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, znj. Besjana Garxenaj, kërkoi konfirmimin në detyrë.

14. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Besjana Garxenaj. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore, për ta rifilluar për shpalljen e vendimit në datën 22.4.2021.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

15. Znj. Besjana Garxenaj ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar në nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj saj.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (ç) deklarinimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës datë 17.7.2020, 21.7.2020, dhe deklarinimet e subjektit gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit; (dh) deklarinimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI; (e) analizën financiare të bërë nga Njësia e Shërbimit Ligjor në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për dosjen nr***prot., datë 10.1.2018, të ILDKPKI-së (sipas neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016), për vlerësimin e pasurisë së subjektit, ku konstatohet:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin,
- nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor për të ardhurat që kanë shërbyer për krijimin e asetëve;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

Nga verifikimi i datës së dorëzimit të deklaratës së pasurisë *Vetting*, në zbatim të nenit 31/1, rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Besjana Garxenaj, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 25.1.2017, në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe ky fakt konfirmohet nga ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Për sa më sipër, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2, të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit, znj. Besjana Garxenaj, është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2015.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Në deklaratën e pasurisë, shtojca 2, dorëzuar në ILDKPKI në datën 25.1.2017, në zbatim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti ka deklaruar:

1. Autoveturë tip “Mercedes-Benz”, prodhimi i vitit 2009, me targa ***, blerë më 16.2.2015. Burimi i krijimit: shitja e një autoveture; të ardhura nga kursime të familjes; si dhe bursa e Shkollës së Magjistraturës. Vlera: 15.000 euro. Pjesa takuese:100%.

Faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ

1.1 Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës të vitit 2015, me përshkrimin “autoveturë tip ‘Mercedes-Benz’, prodhim i vitit 2009 me targa ***, blerë më 16.2.2015. Vlera: 15.000 euro. Burimi: shitja e një autoveture dhe të ardhurat nga kursime familjare, si dhe nga puna si asistente jurist në shoqërinë e ndërtimit ‘K***’ sh.p.k., për periudhën mars 2011 – prill 2012”.

1.2 Për këtë pasuri subjekti ka depozituar¹ kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 16.2.2015, mes palëve: blerëse Besjana Garxenaj dhe shitës E. S. për automjetin tip “Mercedes-Benz”, në vlerën 15.000 euro.

1.3 DPSHTRr-ja² ka informuar se pas verifikimeve të kryera në sistemin informatik ka rezultuar se shtetasja Besjana F. Garxenaj, ka të regjistruar në pronësi të saj automjetin me targa *** dhe ka pasur të regjistruara në pronësi të saj automjetet me targa ***, ***, ***, ***, ***.

Kjo drejtori ka depozituar edhe gjithë dokumentacionin përkatës për secilën targë/automjet që subjekti ka pasur në pronësi.

¹Aneks nr.4/2 në dosjen e ILDKPKI-së

²Shkresë nr. ***prot., datë 16.6.2020.

1.4 Komisioni e ka pyetur³ subjektin lidhur me secilin burim krijimi të kësaj pasurie dhe në përgjigje ka sqaruar se: “...për sa i përket blerjes së automjetit ‘Mercedes Benz’, në vlerën 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro, kam përdorur shumën e përfitur nga shitja e automjetit tip ‘Audi’, me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 5.3.2015, në vlerën 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro. Për sa i përket kontributit të familjes dhe termave të përdorura si kursime të familjes apo të ardhura nga familja, sqaroj se i jam referuar ndihmës që familja ime më ka dhënë para fillimit të detyrës, të cilat lidhen me shpenzimet jetike, që kanë mbuluar nevoja të mia të përditshme si ushqim etj. Këto të ardhura më kanë ndihmuar që unë të kursej pagat dhe bursën që kam marrë prej Shkollës së Magjistraturës”.

Për të konfirmuar të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit tip “Audi”, subjekti ka depozituar kontratën e shitjes së tij.

1.5 Komisioni, për të kryer analizën financiare, ka marrë në konsideratë të ardhurat e përfituara nga subjekti i rivlerësimit për periudhën gusht 2011 – 16.2.2015, në të cilën është investuar në blerjen e kësaj pasurie. Të ardhurat e subjektit rezultojnë nga punësimi në shoqërinë “K***” sh.p.k., si dhe nga bursa e Shkollës së Magjistraturës.

Gjithashtu, për periudhën e analizuar, rezultoi se subjekti ka kryer disa investime, blerje dhe shitje në pasuri të luajtshme.

1.6 Komisioni, në analizë të kontratave të shitblerjeve të automjeteve, konstaton se:

- pasuria automjet tip “Volkswagen/Golf” është blerë në vlerën 1.000 euro, datë 12.11.2012 dhe është shitur në vlerën 980.000 lekë, datë 11.12.2013;
- pasuria automjet tip “Audi A3” është blerë në vlerën 500.000 lekë, datë 9.9.2014 dhe është shitur në vlerën 15.000 euro, datë 5.3.2015 (të ardhurat e kësaj shitjeje kanë shërbyer si burim për pasurinë në fjalë).

1.7 Për këto dy pasuri, në vlerësim të parashikimeve të germës “g”, të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, i cili përcakton se për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale merret si e ardhur e tatueshme çdo e ardhur tjetër e realizuar nga individë rezidentë, që nuk identifikohet në format e paraqitura në këtë nen dhe për sa kohë e ardhura e realizuar nga shitja me fitim e pasurive të luajtshme nuk bën pjesë në të ardhurat e përjashtuara nga neni 8/1 i të njëjtit ligj, Komisioni vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e automjetit (diferenca mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes), nuk e ka marrë në konsideratë për sa kohë nuk është provuar pagimi i detyrimit tatimor mbi këtë fitim. Për rrjedhojë, vlera e fitimit të realizuar nuk mund të trajtohet si ardhur e ligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, kjo vlerë i është zbritur të ardhurës së arkëtuar nga shitja e secilit automjet.

1.8 Pavarësisht se blerja e automjetit “Mercedes-Benz”, me targa ***, është kryer në një periudhë më pak se një muaj përpara se të shitej automjeti tip “Audi A3”, i cili është përdorur si burim, Komisioni i ka marrë në konsideratë këto të ardhura për shkak edhe të marrëdhënies së posaçme mes subjektit të rivlerësimit dhe shitësit⁴ të automjetit.

1.9 Komisioni në analizën e kryer, meqenëse jemi përpara fillimit të detyrës, nuk ka përfshirë shpenzimet e jetesës, pasi subjekti ka deklaruar se këto shpenzime janë mbuluar nga prindërit.

³ Pyetësor nr. 2, datë 25.1.2021.

⁴ I cili është babai i vajzës së subjektit të rivlerësimit.

1.10 Në konkluzion të hetimit administrativ për këtë pasuri, Komisioni konstatoi se edhe pse hetimi u shtri, ndër vite, para fillimit të detyrës, nga analiza financiare e kryer dukej: (i) se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 2.717.062 lekë që të kryente gjithë investimet në periudhën gusht 2011 – shkurt 2015; (ii) se nuk ishte paguar detyrimi tatimor për fitimin e realizuar nga diferenca e krijuar ndërmjet çmimit të shitjes dhe blerjes, për dy automjetet tip “Volkswagen Golf” dhe tip “Audi A3”, duke i kaluar barrën e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

1.11 Subjekti, paraprakisht, ka shpjeguar se në përgjigjet e dhëna gjatë hetimit administrativ i është referuar vetëm dy pasurive, që ka disponuar (deklarata para fillimit të detyrës), gjendjes *cash* dhe automjetit tip “Mercedes-Benz ****”, të cilin e kishte blerë menjëherë nga shitja e automjetit të mëparshëm dhe deklarata para fillimit të detyrës e vitit 2015 ishte plotësuar prej saj, pa iu referuar në atë kohë dokumenteve konkrete për të bërë një përcaktim të saktë të shpërndarjes së të ardhurave.

1.12 Mbi konstatimet e paraqitura në analizën financiare të kryer nga Komisioni, subjekti ka shpjeguar se duke qenë një analizë e kryer, ndër vite, kur nuk ka qenë subjekt deklarues dhe para fillimit të detyrës duhet marrë në konsideratë fakti që ka jetuar me familjen e saj sepse është fëmijë i vetëm dhe prindërit kanë qenë mbështetje për të, jo vetëm gjatë kohës kur ishte studente, pra, jo në marrëdhënie pune, por edhe në vazhdim. Pra, subjekti është mbështetur vazhdimisht nga kursimet e prindërve.

1.13 Në referim të deklarimit më sipër, subjekti ka shpjeguar se dy automjetet konkretisht, automjeti tip “Volkswagen”, viti 2004, blerë me çmim 1.000 euro, me kontratën nr. ***, datë 12.11.2012 dhe automjeti tip “Volkswagen Golf”, viti 2010, blerë me çmim 10.750 euro, me kontratën nr. ***, datë 25.10.2013, janë blerë me kursime të familjes nga puna e prindërve dhe të ardhura të tjera të përfituara prej tyre, me të cilat janë përballuar edhe shpenzimet jetike apo të udhëtimit. Në vijim, janë kryer veprime të njëpasnjëshme, ku me të ardhurat e përfituara nga shitja e një makine është blerë makina tjetër, deri në momentin kur ka deklaruar për herë të parë automjetin e tipit “Mercedes-Benz ****”. Për këto arsye, nga Komisioni duhet të pasqyrohen në analizën financiare kursimet e prindërve, për blerjen e dy automjeteve.

1.14 Për të vërtetuar mundësitë financiare për blerjen e automjeteve dhe për të përballuar çdo shpenzim të kryer, subjekti ka shpjeguar dhe dokumentuar si vijon:

- Të ardhura të punësimit të nënës Z.G., si person fizik tregtar “Z. G.”, për periudhën 1993 – 1995, për të cilat provohet: pagesa e detyrimit tatimor sipas shkresës nr****prot., datë 16.12.2019, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastër; librezat e OSHEE-së; librezat e UK-së; mandatpagesë për taksën e pastrimit; si dhe taksa të tjera.

- Të ardhurat e përfituara prej vitit 2002 dhe deri aktualisht, pasi prindërit zotërojnë dy dyqane, të cilat nga momenti i ndërtimit të tyre janë dhënë me qira, duke përfituar të ardhura të ligjshme. Sipas subjektit ekzistenca e dyqaneve provohet nga disa prova: kontratë shitje trualli nr. ***, datë 17.5.1996 dhe kontratë nr. ***, datë 21.5.1996, prej babait të saj. Dokumenti vërtetim pronësie për sip. 55 m² truall dhe 6 m² truall, lejen e ndërtimit të dhënë me vendimin nr. ***, datë 13.3.2002, të KRRT-së Bashkia Gjirokastër, në cilësinë e investitorit F. G.dhe shtetasit J. K., F. D. dhe Th. D., të cilët kanë ndërtuar banesë masive dhe lokale në lagjen “****”, Gjirokastër.

1.15 Në lidhje me vlerën e ndërtimit të objektit dykatësh, sipas raportit të vlerësimit të kryer në janar të vitit 2021, me porositës F. G., ekspertët kanë konkluduar se: “Bazuar në Udhëzimin e

*Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 31.5.2001, 'Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave', për qytetin e Gjirokastrës është 21.263 lekë/m² sipërfaqe ndërtimi. Sipërfaqja e objektit për të dy katet është 61 m² + 61 m²=120 m². Në koston e shpenzuar nga F. G. do të llogaritet vetëm kostoja e katit të parë 61 m², pasi katin përdhe e ka investuar investitori i pallatit ngjitur me pronën, mbështetur në aktmarrëveshjen e datës 15.2.2002 (bashkëlidhur këtij raporti), 61m² x 21.263 lekë/m² = 1.297.043 lekë. Kostoja e ndërtimit të objektit për 1 kat në vitin 2002 ka qenë 1.297.043 lekë (një milion e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e dyzetë e tre) lekë". Pra, kostoja e ndërtimit të objektit, llogaritur sipas vlerave të Entit Kombëtar të Banesave të Gjirokastrës, rezulton të jetë 1.297.043 lekë, për katin e dytë të objektit. Midis babait të subjektit dhe investitorëve të tjerë është lidhur aktmarrëveshja, datë 15.2.2002, ku palët kanë rënë dakord se kati i parë do të ndërtohet nga pala tjetër (Th. D., F. D. dhe J. K.), pra, prindërit nuk kanë shpenzuar për të. Për të provuar se dyqanet kanë qenë funksionale dhe janë dhënë me qira, subjekti ka vendosur në dispozicion shkresën vërtetim debie nr. *** prot., datë 17.2.2021, të Furnizuesit të Shërbimit Universal (OSHEE), ku provohet se ekzistojnë dy nënkontrata me titullar/përdorues F. G. dhe është lidhur kontrata e qirasë nr. *** rep., datë 20.1.2004, me afat 1-vjeçar, me çmim 15.000 lekë/muaj, me qiradhënësin F. G. dhe qiramarrës shoqëria "G****" sh.p.k. Në vijim, është lidhur aktmarrëveshja, datë 1.3.2005, me qiramarrës shtetasin H. P. dhe qiradhënësin F.G., me çmim 20.000 lekë/muaj dhe me afat deri më 30.9.2018. Po ashtu, është lidhur aktmarrëveshja, datë 4.4.2004, me qiramarrës K.K. dhe E. K. dhe qiradhënësin F. G., me çmim 15.000 lekë/muaj, me afat deri më 30.1.2017. Për të tria kontratat palët kanë rënë dakord se pagesa do të bëhet cash. Kontratat janë lidhur në formë shkresore në respektim të nenit të Kodit Civil sipas së cilit: "Kontrata e qirasë, për një kohë më të gjatë se një vit, duhet bërë me shkresë". Në lidhje me detyrimin e pagesës së tatimit për të ardhurat nga qiraja në kontratën e qirasë nr. *** rep., lidhur me shoqërinë "G****" sh.p.k., në kontratë palët kanë rënë dakord se: "Qiramarrësi detyrohet të paguajë rregullisht të gjitha detyrimet ndaj shtetit, detyrimet për energjinë elektrike dhe ujin e harxhuar etj.". Ky detyrim me marrëveshje i është lënë në ngarkim qiramarrësit. Ky fakt provohet edhe nga urdhërpagesa, data e pagesës mars (e pa specifikuar), në të cilën rezulton e pasqyruar se tatimpaguesi që mban tatimin në burim është shoqëria "G****" sh.p.k., me NIPT ***, për qiradhënësin F.G., në masën 4.500 lekë (dokumentet e tjera nuk ka qenë e mundur të sigurohen për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar). Në lidhje me dy kontratat e tjera rezulton se në aktmarrëveshje palët nuk kanë përcaktuar në mënyrë të shprehur, për pagesën e detyrimit tatimor për të ardhurat nga qiraja. Sipas shpjegimeve që ka dhënë babai i subjektit, z. F. G., ky detyrim me marrëveshje verbale i është lënë në ngarkim qiramarrësve, kjo nisur edhe nga vlera e ulët e çmimit të qirasë dhe pasi është interesuar në Drejtorinë Rajonale të Tatimore Gjirokastrë, nuk ka gjetur dokumentacion dhe nuk ka marrë informacion të saktë nëse është paguar ose jo ky tatim. Në deklaratën noteriale të dyanshme nr. ***, datë 16.2.2021, palët deklarojnë se: "Unë deklaroj H. P. deklaroj se me shtetasin F.G. kam lidhur kontratë qiraje për një dyqan, pronë e shtetasit F. G. e ndodhur në lagjen '***', pranë kopshtit S. , Gjirokastrë. Kontrata e qirasë ka qenë me afat 30.4.2005 – 30.9.2018, me pagesë mujore 20.000 lekë/muaj. Tatimi në burim do të paguhej prej meje dhe për këtë detyrim kemi rënë dakord me marrëveshje verbale. Deklarojmë se biem dakord që ky detyrim do të paguhej nga unë H. P.për shtetasin F.G. dhe unë H. P. e njoh si detyrim dhe do t'ia paguaj me këste. Deklaroj se ky detyrim nuk është paguar më parë. Këtë deklaratë noteriale e miraton, e nënshkruan edhe F. G.". Për sa i përket aktmarrëveshjes së datës 4.4.2004, shtetasja E.K.(K.), duke qenë se aktualisht jeton jashtë Shqipërisë, ka dërguar në e-mail e subjektit (babai i subjektit nuk disponon dhe nuk përdor një të tillë), datë 16.2.2021, ora 20:34, deklaratë dhe dokumentet identifikuese, ku ka deklaruar se: "Unë E. K. (K.) e datëlindjes 1.3.1970*

dhe me numër personal *** deklaroj se me shtetasin F. G., banues në Gjirokastrë, kam lidhur një kontratë qiraje për një dyqan të ndodhur në lagjen “***”, Gjirokastrë, me afat 5.5.2004 – 30.1.2017. Ne kemi rënë dakord me marrëveshje verbale që tatimi në burim do të paguhej prej meje, por këtë detyrim unë nuk e kam paguar. Deklaroj se bie dakord që nëse ky detyrim paguhet prej shtetasit F.G., unë e njoh si detyrim dhe do tija paguaj atij me këste. Duke qenë se unë aktualisht ndodhem jashtë Shqipërisë dhe nuk kam mundësi për të kryer procedurat përkatëse të pagesës. Bashkëngjitur po dërgoj kartën e identitetit dhe, gjithashtu, kartën e rezidencës të Anglisë”. Ky e-mail është hapur në prani të noteres dhe përmbajtja e tij dhe dokumenteve të dërguara është certifikuar nga noteri me shkresën vërtetim i kopjes së komunikimit elektronik me origjinalin, nr. *** rep., datë 30.3.2021.

1.16 Subjekti ka shpjeguar se babai i saj me marrjen dijani se detyrimet nuk ishin paguar, edhe pse nuk e ka pasur detyrim për të paguar tatimin për të ardhurat e qirasë, ka paguar detyrimet për sa më sipër, fakt që rezulton nga mandatpagesa, datë 23.2.2021, në “Raiffeisen Bank”, për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në shumën 615.450 lekë, me përshkrimin tatim në burim për qiratë e dyqaneve prej vitit 2004. Po ashtu, ka paguar edhe shumën prej 45.200 lekësh, me mandatpagesën datë 19.12.2019, në “Raiffeisen Bank”, për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me përshkrimin tatim në burim prej vitit 2004.

1.17 Fakti që babai i subjektit nuk ka qenë në dijani të detyrimit të papaguar prej qiramarrësve, rezulton edhe nga shkresa kthim përgjigje nr. *** prot., datë 16.12.2019, e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Gjirokastrë, sipas së cilës i është kthyer përgjigje se: “Lidhur me sa kërkoni për tatim qiraje (tatim i mbajtur në burim) për periudhën 2013 – 2019, ju informojmë se pas verifikimit në sistemin informatik tatimor C@TS, ju si person nuk figuroni i regjistruar në organin tatimor me status ligjor IP, Individ Privat dhe i ngarkuar me përgjegjësi tatimore tatim i mbajtur në burim, për të paguar këtë lloj tatimi”, si dhe nga shkresa nr. *** prot., datë 10.12.2019, e Bashkisë Gjirokastrë, sipas së cilës vërtetohet se: “F. G. nuk figuron në regjistrin e biznesit të vogël në zyrën e taksave në Bashkinë Gjirokastrë dhe nuk ka detyrime pranë kësaj zyre”. Praktika e ndjekur për të tria kontratat është e njëjtë dhe në përputhje edhe me parashikimet në ligjin ndryshues nr. ***, “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, ku legjislatori parashikoi detyrimin e mbajtjes në burim nga qiramarrësi të tatimit për pagesat për qiratë. Po ashtu, fakti që detyrimi është caktuar se i përket qiramarrësve me marrëveshje verbale, korrespondon edhe me parashikimin e përcaktuar që në kontratën e parë të qirasë, nr. *** rep., datë 20.1.2004, si dhe me çmimin e qirasë, i cili është caktuar në një vlerë të ulët.

1.18 Subjekti, për të provuar mundësitë financiare të prindërve, ka depozituar kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. ***, vol. ***, f. ***, datë 12.9.2002, apartament me sip. 55 m², ndodhur në lagjen “***”, Gjirokastrë, me shitës F. G. dhe Z. G. dhe blerës A. K., në shumën 1.000.000 lekë. Kjo pasuri rezulton e regjistruar në pronësi të shtetasës A. K., duke konkluduar se sipas saj plotësohen në mënyrë kumulative kushtet: (i) pasuria bazohet në burime/akte të ligjshme; dhe (ii) detyrimet tatimore janë paguar.

1.19 Lidhur me konstatimin e Komisionit, se dukej se nuk është paguar detyrimi tatimor për fitimin e realizuar nga diferenca e krijuar ndërmjet çmimit të shitjes dhe blerjes dhe, për pasojë, në përlllogaritjet e tij, Komisioni, ka marrë në konsideratë vlerën e blerjes së këtyre automjeteve, subjekti ka shpjeguar dhe depozituar dokumentacionin në vijim:

- Për automjetin tip “Volkswagen” çmimi i shitjes është vendosur më lirë, pasi është blerë nga shtetasi E. S., me të cilin personalisht kishte pasur një lidhje, fakt i vendosur edhe në kontratë dhe

prej së cilës kanë edhe një fëmijë. Çmimi i shitjes përkonte me çmimin e tregut të automjetit dhe pagesa ishte bërë me bankë.

- Automjeti tjetër tip “Audi 3” kishte çmim më të ulët blerje, pasi këtë automjet e kishte blerë nga shtetasi B. I., i cili ushtron veprimtari në shitblerjen e automjeteve dhe është regjistruar si person fizik tregtar që prej vitit 2009, duke depozituar dhe dokumentacion për këtë fakt. Sipas subjektit këtë automjet e kishte blerë më lirë, pasi në të njëjtën datë para të njëjtës notere dhe po nga i njëjti shtetas kishte blerë një automjet tjetër në vlerën 950.000 lekë, i cili ishte me i ulët në krahasim me vlerën e çmimeve të tregut, pra, me dy veprimet juridike është bërë kompensim midis tyre (si formë shkëmbimi dhe plotësimi i vlerave përkatëse reale të tregut), në eventualitet të shitjes së tyre në të ardhmen.

Subjekti ka shpjeguar se këto veprime juridike janë kryer shumë kohë më parë se të ushtronte detyrën e gjyqtarës dhe, si rrjedhojë, nuk ka pasur asnjë qëllim për të pasqyruar vlera fiktive, me qëllim shtimin e pasurisë në mënyrë fiktive.

1.20 Në lidhje me tatimin për të ardhurat e përfituara nga shitblerja e automjeteve, subjekti ka depozituar pagesën e tyre, datë 2.2.2021, për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

1.21 Për situatën e mësipërme, subjekti ka theksuar faktin se këto veprime juridike janë kryer shumë kohë më parë se të ushtronte detyrën e gjyqtarës dhe në kohën që kontratat janë lidhur nuk ka qenë subjekt deklarimi dhe as në marrëdhënie pune (në atë kohë me një eksperiencë pune tepër minimale - si asistent juriste në vitin 2011), pra, në raport edhe me parashikimet ligjore⁵ të detyrimeve tatimore për këto të ardhura, ku formulimi ligjor faktikisht nuk ka pasur një parashikim në mënyrë eksplicite se të ardhurat e përfituara nga shitja e automjeteve taten, qoftë në ligj apo aktet nënligjore.

1.22 Në përfundim, subjekti shprehet se në konsideratë të shpjegimeve të mbështetura në dokumentacionin/provat përkatëse, rezulton se së bashku me prindërit ka pasur mundësi financiare për të kryer investimet e cituara në rezultatet e hetimit administrativ, të përballonin shpenzimet, duke paraqitur në formë tabelare përlllogaritjet e saj, me një bilanc pozitiv në shumën 1.060.640 lekë.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

1.23 Trupi gjykues, në analizë të provave të administruara, fakteve dhe rrethanave të cilësuar më sipër, përgjigjeve të subjektit në pyetësorë, parashtrimeve, si dhe provave të depozituara në funksion të barrës së provës, arsyeton si vijon:

- Pasuria automjet tip “Mercedes-Benz”, e deklaruar në deklaratën *Vetting* objekt hetimi, konfirmohet e përfutur sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 16.2.2015, mes palëve, blerëse Besjana Garxenaj dhe shitës E. S., në vlerën 15.000 euro. Po ashtu, këtë pasuri subjekti e ka

⁵ Ligji “Për tatimin mbi të ardhurat”, në nenin 8 të tij, nuk përcakton në mënyrë eksplicite se janë të tatueshme edhe të ardhurat që përfitohen nga shitja e automjetit. Madje as në Udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2006, nuk ka një përcaktim të qartë se edhe për këto të ardhura duhet të paguhet tatimi. Në pikën 2.3.9 të Udhëzimit gjendet ky parashikim: “*Të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen (pika g). Në këtë grup përfshihet çdo lloj e ardhure me burim në Republikën e Shqipërisë e realizuar nga individë rezidentë ose jo rezidentë, por që nuk identifikohet në format e paraqitura më lart. Në këtë grup përfshihen të ardhurat nga sponsorizimet (p.sh. individë të ndryshëm që nuk janë të regjistruar në organet tatimore marrin sponsorizime nga burime të ndryshme dhe i përdorin për aktivitete artistike apo sportive), të ardhura nga aktiviteti profesional si mësimdhënie, trajnime, shkrime në gazeta, etj., kur përfituesi nuk është i regjistruar në organet tatimore (dhe aktivitete të tilla i ka të përkohshme apo dytësore). Siç shihet, në të gjitha rastet personi përfitues nuk është i regjistruar në organet tatimore, pra nuk i deklaroi ato të ardhura në të ardhurat e tatueshme të biznesit...”. Pra, edhe në shembujt që janë sqaruar në Udhëzimin nr. 5, shprehet subjekti, nuk citohet se të ardhurat që përfitohen nga shitja e automjetit, taten.*

deklaruar edhe në deklaratën periodike para fillimit të detyrës. Duke analizuar deklaratimet e subjektit, rezulton se burimi i deklaruar janë të ardhurat nga shitja e një autoveture, të ardhurat nga kursime familjare, si dhe bursa e Shkollës së Magjistraturës. Po ashtu, nga DPSHTRr-ja konfirmohet, shitja e automjetit tip “Audi A3”, sipas kontratës nr. ***, datë 5.3.2015, në të njëjtën shumë dhe duke parë këto transaksione me të njëjtën shumë, duket se provohet burimi i ligjshëm i kësaj pasurie.

Pavarësisht, se kjo pasuri është blerë para detyrës me burime të përfituara po para detyrës, Komisioni hetoi për ligjshmërinë e tyre, duke e shtrirë hetimin shumë vite para detyrës, nisur jo vetëm nga burimi i deklaruar, kursime të familjes dhe bursa nga Shkolla e Magjistraturës, por edhe nga të dhënat e tjera të dala nga hetimi, ku subjekti rezultonte të kishte kryer disa investime në blerje/shitje automjetesh.

Nën analizimin e dokumentacionit të depozituar për balancën negative, Komisioni vlerëson se subjekti ka provuar me dokumentacion: (a) punësimin e babait nga viti 1994 dhe në vazhdim në ndërmarrje shtetërore, konfirmuar⁶ nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Gjirokastrë; (b) të ardhurat e përfituara për periudhën 1994 – shkurt 2015, janë në vlerën 5.135.929 lekë; (c) punësimin e nënës si e vetëpunësuar si person fizik⁷ dhe që ka siguruar të ardhura nga aktiviteti privat për vitet 1994 –1995, me xhiro të realizuar⁸ në vlerën 618.500 lekë (në këtë rast, trupi gjykues nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor ka vlerësuar të përlllogarisë marzhin e fitimit në masën 15% të xhiros, pra, vlerën 92.775 lekë); (d) shitjen e banesës⁹ në pronësi të babait me sip. 55 m², në vlerën 1.000.000 lekë, në shtator të vitit 2002 në Gjirokastrë; (e) përfitimin dhe dhënien me qira të dy dyqaneve¹⁰ nga babai nga viti 2004 dhe në vazhdim, në Gjirokastrë. Të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira për periudhën 2004 – shkurt 2015, janë në vlerën 3.635.000 lekë.

1.24 Lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave nga qiratë e dy dyqaneve, rezulton se babai i subjektit ka paguar në vitin 2021 tatimin në burim për këto të ardhura, në shumën 660.250 lekë. Trupi gjykues çmon së në këtë situatë duhen të mbahen në konsideratë rrethanat specifike që paraqiten dhe, më konkretisht: (i) subjekti, nga momenti i parë kur kanë filluar të jepen me qira dyqanet (viti 2004) ka qenë në moshën 16 vjeç dhe nuk ka qenë në detyrë; (ii) këto të ardhura janë përfitur nga prindërit, të cilët nuk kanë qenë subjekt deklarimi; (iii) provohet me dokumentacion mënyra e përfitimit të pasurisë truall¹¹ që prej vitit 1996, ndërtimi i dyqaneve¹² në vitin 2002 , si dhe dhënia me qira e tyre prej vitit 2004 me të njëjtët qiramarrës gjatë gjithë periudhës, për secilin dyqan, fakte këto që në tërësi marrin peshë në raport me tatimin e paguar nga babai i subjekti në datën 23.4.2021 dhe, për rrjedhojë, ato duhet të merren në konsideratë në analizën financiare.

1.25 Lidhur më të ardhurat e përfituara nga subjekti i rivlerësimit nga shitja e dy automjeteve, për të cilat është paguar detyrimi tatimor (diferenca mes çmimit të shitjes dhe blerjes), gjatë procesit

⁶ Me dokumentacionin, vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare me punëdhënësin Agjencia e Shërbimit Publik, Ndërmarrja Komunale, Policia Elektrike Gjirokastrë dhe Shtëpia e Ushtarakëve Gjirokastrë.

⁷ Konfirmuar me vërtetim për bazën e vlerësuar nga DRSSH-ja Gjirokastrë ku evidnetohet derdhja e kontributeve si person fizik.

⁸ Konfirmuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë me shkresën “Kthim përgjigje nënës së subjektit, shtetases Z.G.” nr. ***prot., datë 16.12.2019.

⁹ Me kontratë shitje pasuri e paluajtshme nr. ***, datë 12.9.2002.

¹⁰ Me kontratë qiraje nr. *** rep., datë 20.1.2004, me palë qiradhënëse F. G. dhe qiramarrës, Firma “G***” sh.p.k.; aktmarrëveshje, datë 1.3.2005, me palë qiradhënëse F. G. dhe qiramarrës H. P.; aktmarrëveshje, datë 4.4.2004, me palë qiradhënëse F. G. dhe qiramarrës E.K. dhe K.K. .

¹¹ Me kontratë shitje truall nr. ***, datë 17.5.1996 dhe nr***, datë 21.5.1996.

¹² Me leje ndërtimi dhënë me vendimin nr. ***, datë 13.3.2002, të KRRT-së lëshuar në datën 28.3.2002; aktmarrëveshje, datë 15.2.2002, ku pasqyrohet se palët bien dakord t’i ndërtojnë babait të subjektit, shtetasit F.G., katin e parë të objektit të tij sipas lejes që ka marrë.

të rivlerësimit, trupi gjykues çmon faktet në vijim: (i) subjekti i rivlerësimit është palë në këto kontrata; dhe se (ii) standardet e vendosura nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, diktojnë që këto të ardhura nuk duhen të merren në konsideratë në përlllogaritjet e kryera. Këto fakte prevalojnë mbi rrethanat e paraqitura dhe shpjegimet e dhëna apo dokumentacionin e depozituar prej subjektit edhe pse këto veprime janë kryer kur nuk ka qenë në detyrë. Për pasojë, analiza financiare për situatën e konstatuar nga Komisioni, edhe pse para detyrës, është kryer nga viti 1994 – 16.2.2015, datë në të cilën është investuar në blerjen e automjetit.

1.26 Trupi gjykues, në tërësi për çështjen objekt vlerësimi, arsyeton se pasuria automjet është deklaruar me vërtetësi dhe saktësi nga subjekti i rivlerësimit. Në raport me rrethanat e paraqitura, se hetimi mbi burimet e kësaj pasurie është i ndërlidhur në kohën kur ka jetuar me prindërit, duke mos qenë në marrëdhënie pune dhe as në detyrë, si dhe për faktin se subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion, duke shfaqur kështu sjellje të bashkëpunimit, vlerëson se balanca negative e mbetur në vlerën prej 610.875 lekësh, në datën e blerjes së automjetit, në raport me vlerësimin tërësor të procesit, nuk mund të përbëjë shkak të mjaftueshëm për aplikimin e ndonjë kualifikimi ligjor për pozitën e saj si subjekt rivlerësimi.

2. Gjendje cash, në shumën 9.000 euro, datë 25.1.2017

2.1 Lidhur me likuiditetin *cash*, Komisioni ka konstatuar se subjekti e deklaroi për herë të parë gjendjen *cash* në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës të vitit 2015, me përshkrimin: *“Gjendje cash, shuma 6.000 euro. Burimi: të ardhura nga kursime personale si rezultat i bursës nga Shkolla e Magjistraturës dhe të ardhura familjare”*.

2.2 Ndërsa në deklaratën periodike të vitit 2016, subjekti deklaroi: *“Gjendje cash më 31.12.2016, shuma 8.500 euro. Burimi: të ardhura nga kursime personale të mëparshme si bursa e Shkollës së Magjistraturës, kursime familjare dhe paga.”*

2.3 Meqenëse subjekti ka deklaruar si burim për gjendjen *cash* edhe të ardhura nga familja, Komisioni e ka pyetur¹³ se sa ka qenë kontributi i familjes në krijimin e kësaj gjendjeje. Subjekti në përgjigjen e saj, ndër të tjera, ka sqaruar se: *“... sa i përket shumës cash prej 6,000 (gjashtë mijë) euro, kjo shumë ka ardhur si rezultat i përfitimeve të mia nga bursa e Shkollës së Magjistraturës dhe pagës për punën e kryer pranë shoqërisë ‘K***’ sh.p.k. Kontributi i familjes në rastin konkret ka qenë minimal, periodik, me para ose kontribut në blerje si ushqime, veshje etj., dhe nuk mund të përcaktoj me saktësi se sa kanë qenë këto të ardhura, duke qenë se ka pasur bashkim të së ardhurave të mia me ndihmën e prindërve të mi. Pra, kontributi i familjes sime ka qenë minimal dhe shpenzimet janë mbuluar për të dyja pasuritë, vetëm prej të ardhurave të mia”*.

2.4 Komisioni kreu analizën për të parë mundësinë financiare të subjektit nëse kishte mundësi ta krijonte këtë gjendje *cash*. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, duket se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare të krijojë shumën 6.000 euro përpara fillimit të detyrës, ta shtojë atë përgjatë vitit 2016 dhe përpara deklaratës *Vetting*, me një balancë negative në shumën 555.013 lekë, për të cilën i kaloi barrën e provës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

2.5 Mbi konstatimin e Komisionit, subjekti ka shpjeguar se është ndihmuar nga prindërit përgjatë viteve 2015, 2016 dhe 2017, për shkak të situatës dhe nevojave ekonomike të krijuara. Në lidhje me këtë kontribut ka sqaruar se për sa i përket qirasë së banesës në vitet 2015, 2016 dhe 2017,

¹³ Pyetësor nr. 2, datë 25.1.2021.

pagesa është bërë prej prindërve, pasi ka jetuar në një banesë me qira së bashku me nënën, të cilën e ka pasur ndihmë të vazhdueshme, për shkak të lindjes së fëmijës, shkëputjes së raportit me partnerin dhe faktit se është fëmija i vetëm i familjes. Pra praktikisht, ka jetuar në banesën e marrë me qira prej prindërve dhe qiraja e banesës mbulohej nga të ardhurat e tyre. Po ashtu, fakti se qiraja mbulohej nga të ardhurat e prindërve rezultoi edhe nga kontrata e qirasë e datës 2.12.2016, e cila është lidhur midis nënës Z. G. dhe qiradhënësit A. A., me afat për 2 vjet. Subjekti sqaron se kontrata e qirasë e datës 24.11.2015 është lidhur midis saj dhe qiradhënësit A. A., për formalizimin sa më të shpejtë, pasi banesa është gjetur nëpërmjet njoftimit në internet dhe ajo është ndodhur në atë moment në Tiranë, pasi do të fillonte stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (sipas dekretit nr. 9326, datë 20.11.2015, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, stazhi do të kryhej në periudhën 20.11.2015 – 30.6.2016). Shpenzimet për qira të përlllogaritura në vitet 2015, 2016 dhe 2017, nuk janë mbuluar nga të ardhurat e subjektit, por nga prindërit dhe ato duhet të pasqyrohen në analizën financiare si shpenzime me burim nga të ardhurat e prindërve.

2.6 Lidhur me shpenzimet jetike për fëmijën H. S., subjekti ka shpjeguar se ato janë paguar në mënyrë të barabartë midis saj dhe babait të fëmijës E.S. dhe, si rrjedhojë, shuma prej 117.500 (njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë, duhet të zbritet nga shpenzimet në vitin 2016. Kontributi i tij ka qenë periodik (çdo muaj), kryesisht material, nëpërmjet blerjes së ushqimeve, veshjeve për fëmijën etj., të cilat përmbushnin pjesërisht nevojat e fëmijës por në raste të veçanta edhe *cash*. Për këto shpenzime të dy kanë rënë dakord në këtë mënyrë dhe ky fakt gjen parashikim edhe në nenin 209/1 të Kodit të Familjes sipas së cilit: *“Personi që ka detyrimin për ushqim ka të drejtën e zgjedhjes për përmbushjen e detyrimit nëpërmjet pagesës bankare ose të drejtpërdrejtë, që parapaguhet periodikisht, ose duke e mbajtur në shtëpinë e tij atë që merr detyrimin për ushqim.”*

2.7 Po ashtu, ka sqaruar se në datën 25.1.2017, në “Raiffeisen Bank” gjendja në llogarinë bankare nr. *** – ALL, llogari page, ka qenë në shumën 3.938 lekë dhe, për pasojë, ndryshimi i likuiditeteve në analizën financiare, datë 25.1.2017, është në shumën 3.753 lekë dhe jo në shumën 83.088 lekë sikurse është llogaritur nga Komisioni.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

2.8 Trupi gjykues, në analizë të provave të administruara, fakteve dhe rrethanave të cilësuar më sipër, përgjigjeve të subjektit në pyetësorë, parashtrimeve të tij në prapësime, si dhe provave të depozituara në funksion të barrës së provës, arsyeton si vijon:

2.9 Për pretendimin e subjektit se prindërit e kanë ndihmuar duke paguar shpenzimet e qirasë së banesës, trupi gjykues në analizë të dokumentacionit të depozituar dhe përlllogaritjeve të kryera nga Njësia e Shërbimit Ligjor, vlerësoi ta marrë pjesërisht në konsideratë këtë pretendim. Kjo, për faktin se kontrata e qirasë për vitin 2016 është në emër të nënës së subjektit dhe se në deklaratën periodike të vitit 2016, në rubrikën e adresës së banimit, subjekti përveç adresës ka deklaruar se është shtëpia e prindërve të cilët e posedojnë me kontratë qiraje. Trupi gjykues, në analizim të provave të depozituara, konstaton se të ardhurat e prindërve të subjektit nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar të gjithë këtë shpenzim, për pasojë, vlerëson se prindërit e subjektit mund të mbulojnë vetëm 1/2 (gjysmën) e shpenzimit për sa i përket qirasë së banesës.

2.10 Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni duhet të reduktojë shpenzimet e jetesës së vajzës, pasi ato janë mbuluar edhe nga babai i fëmijës, trupi gjykues vlerëson se për sa kohë subjekti nuk ka depozituar dokumentacion provues dhe nuk i ka deklaruar në asnjë deklaratë

periodike, ato mbeten në nivel deklarativ dhe, për rrjedhojë, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

2.11 Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni nuk ka përlogaritur saktë ndryshimin e likuiditeteve në datën 25.1.2017, trupi gjykues çmon se ky pretendim nuk qëndron, pasi subjekti ndryshimin e likuiditeteve e kryen vetëm duke u bazuar në diferencën e gjendjes bankare dhe nuk përfshin shtesën e gjendjes *cash*. Përlogaritja nga Njësia e Shërbimit Ligjor është rezultat edhe i analizimit të deklarimeve të gjendjes *cash*, ku konkretisht në vitin 2016 subjekti kishte deklaruar gjendje *cash* në vlerën 8.500 euro dhe në deklaratën *Vetting* ka deklaruar gjendje *cash* në vlerën 9.000 euro. Pra, nëse viti 2016 është mbyllur në vlerën 1.149.980 lekë (*cash* + bankë), në datën 25.1.2017, likuiditetet janë në vlerën 1.233.068 lekë (*cash* + bankë). Për rrjedhojë, diferenca është në shumën 83.088 lekë dhe jo në shumën 3.938 lekë, siç pretendon subjekti.

2.12 Pas rilogaritjeve rezultoi se subjekti gjendej në balancë negative në vlerën 373.012 lekë, përkatësisht në vlerën 310.958 lekë për viti 2016 dhe në vlerën 62.055 lekë në datën e depozitimit të deklaratës *Vetting*.

2.13 Trupi gjykues, në vlerësim të balancës negative, në një masë relativisht të ulët, por edhe e shpërndarë në dy vite kalendarike, si dhe nën rrethanat faktike të kësaj çështjeje arsyetuar më sipër, çmon se kjo pamundësi financiare nuk mund të përbëjë shkak për aplikimin e ndonjë mase disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit.

3. Llogari bankare page në “Raiffeisen Bank”, me gjendje në vlerën 3.937,67 lekë, datë 25.1.2017. Burimi: të ardhura nga paga si punonjëse pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Vlera: 3.900 lekë. Pjesa takuese: 100%. Nga hetimi ka rezultuar se “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. *** prot., datë 12.6.2020, konfirmon llogari page në emër të shtetases Besjana Garxenaj, me gjendje në datën 25.1.2017 në vlerën 3.937,67 lekë, për rrjedhojë, trupi gjykues konkludon se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e ardhur nga “Raiffeisen Bank”.

4. Kontratë sigurimi i jetës me kursim, kohëzgjatja 20 vjet, nga 1.5.2016 – 30.4.2036, polica nr. serie ***, datë 11.4.2016. Primi vjetor i sigurimit 2.500 euro.

4.1 Nga hetimi administrativ ka rezultuar se subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2016, kontratë sigurimi i jetës me kursim, kohëzgjatja 20 vjet, nga 1.5.2016 – 30.4.2036, Polica nr. Serie ***, datë 11.04.2016. Primi vjetor i sigurimit 2.500 euro/muaji.

Për këtë deklaramin subjekti ka depozituar¹⁴: policë sigurimi, datë 11.4.2016, në emër të znj. Besjana Garxenaj, filluar më 1.5.2016 – 30.4.2036, në vlerën 2.500 euro.

4.2 Në pyetësorin e parë subjekti ka depozituar dokumentin nga shoqëria e sigurimeve “****”, nr. *** prot., datë 11.12.2019, ku konfirmohet se për periudhën e sigurimit 1.5.2016 – 30.4.2017, ka paguar shumën 2.500 euro, në datën 31.3.2016. Në vlerësim të deklarimeve dhe dokumentacionit që konfirmon këtë deklaramin, trupi gjykues çmon se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur, duke mos konstatuar ndonjë problematikë.

¹⁴ Aneks nr. 4/5, në dosjen e ILDKPKI-së.

5. Lidhur me adresat e banimit

5.1 Komisioni ka hetuar mbi adresat e banimit, për të verifikuar lidhjen e subjektit me këto adresa. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës të vitit 2015, si dhe në deklaratën *Vetting* ka deklaruar adresat në vijim:

5.1.i Adresa e regjistrimit në Gjendjen Civile: Rruga ***, Pallati ***, Kulla***, kati ***, Ap. ***, Njësia Administrative Nr. ***, Tiranë.

5.1.ii Adresa e plotë e banimit: Lagjja “****”, Pallati ***, Ap. ***, ***, Tiranë.

5.2 Në deklaratën periodike të vitit 2016 është i njëjti deklarim por ka shtuar te adresa e plotë e banimit shënimin “shtëpia e prindërve të cilët e zotërojnë me kontratë qiraje”.

5.3 Në pyetësin standard, lidhur me adresat e banimit, ka depozituar kontratën e qirasë, datë 24.11.2015, me palë qiradhënëse shtetasin A.A. dhe qiramarrës shtetasja Besjana Garxenaj. Në kontratë qiraja mujore është përcaktuar vlera 200 euro dhe është pasqyruar se në datën e lidhjes së saj është paguar qiraja e muajit dhjetor 2015. Gjithashtu, në këtë akt, është përcaktuar se në datën 1.12.2015, do të jepet edhe një muaj pagesë në shumën 200 euro garanci për muajin e fundit. Për këtë arsye, Komisioni në analizën e kryer për vitin 2015, ka përfshirë si shpenzime qiraje dy muaj.

5.4 Po në këtë pyetësor, subjekti ka depozituar kontratën e qirasë, datë 2.12.2016, me palë qiradhënëse shtetasi A.A. dhe qiramarrës shtetasja Z. G. (nëna e subjektit të rivlerësimit). Qiraja mujore është në vlerën 250 euro.

5.4.i Përsëri, po në këtë pyetësor, subjekti ka deklaruar se prej gushtit të vitit 2018 ka të drejtën e banimit, pa pagesë qiraje në apartamentin i cili është në pronësi të shtetasit E. S. me adresë rruga “****”, pranë K., Tiranë.

5.5 Në analizën financiare të kryer nga Komisionit janë përfshirë shpenzimet e qirasë për dy muaj për vitin 2015 dhe 12 (dymbëdhjetë) muaj në vitin 2016.

5.6 Komisioni, lidhur me deklarinimin e subjektit se, prej gushtit të vitit 2018, ka të drejtën e banimit pa pagesë qiraje në apartamentin, i cili është në pronësi të shtetasit E. S. me adresë rruga “****”, pranë K., Tiranë, verifikoi mënyrën e përfitimit të pasurisë nga ky shtetas. Nga aktet e administruara¹⁵ rezultoi se kjo pasuri është përfituar me kontratë premtimi dhe kalim të drejtash reale për pasuri të paluajtshme, nr. ***, datë 14.4.2014, në vlerën 50.000 euro¹⁶. Për faktin se, kjo pasuri i është dhënë subjektit të rivlerësimit në vitin 2018, pra pas deklaratës *vetting*, dhe për shkak se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në detyrë në kohën e blerjes së saj, trupi gjykues nuk konstaton ndonjë problematikë, si dhe nuk krijon dyshime lidhur me këtë pasuri, në raport me subjektin e rivlerësimit.

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit

¹⁵ Shih përgjigjen e dhënë në pyetësin nr.1/standard, dt 4.12.2019 dhe dokumentacionin shoqërues.

¹⁶ Nga aksesi institucional në ASHK rezulton që kjo pasuri është regjistruar në vitin 2020 në emër të shtetasit S. në po të njëjtën vlerë.

84/2016, ka dërguar për subjektin e rivlerësimit, Raportin mbi kontrollin e figurës nr. *** prot., datë 2.11.2017, të deklasifikuar me vendim nr. ***, datë 4.8.2020, të KDZh-së, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar: Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Besjana Garxenaj.

Më tej, Komisioni ka kërkuar përditësimin e raportit. DSIK-ja ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 3.3.2021, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 28.3.2021, sipas të cilit ka konkluduar në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, znj. Besjana F. G. .

2. Ndër të tjera në raport thuhet se:

Në vijim të informacioneve të ardhura nga institucioni i verifikimit, në kohështirje gjatë periudhës së rivlerësimit për përfshirje në korrupsion pasiv të subjektit të rivlerësimit, znj. Besjana Garxenaj, në më shumë se një rast rezulton se:

- Gjatë periudhës në të cilën znj. Besjana Garxenaj ushtronte detyrën si gjyqtare, stazhiere në vitin 2018 ka ...përfshirje në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur gjatë gjykimit të një çështjeje penale.
- Gjithashtu, për subjektin Besjana F. Garxenaj, në cilësinë e gjyqtarit stazhier, disponohen të dhëna të vitit 2017... ku, vihem në dijeni ...për përfshirje të saj në veprimtari korruptive gjatë gjykimit të një çështjeje civile.

3. Grupi i Punës nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, ndryshon konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, znj. Besjana F. Garxenaj.

4. Komisioni, paraprakisht nga të dhënat e pasqyruara në raportin e vlerësimit profesional të subjektit nga KLGj-ja, konstatoi se subjekti është caktuar për të ushtruar funksionin e gjyqtares, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. ***, datë 21.2.2017, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, pra, statusi *stazhier* nuk është i pranishëm pas datës 21.2.2017.

5. Nisur nga konkludimet e bëra prezent në raportin e DSIK-së, Komisioni ka aksesuar në dokumentacionin e klasifikuar të poseduar nga institucionet verifikuese, për t'i studiuar ato, si dhe për të verifikuar bazueshmërinë e konkluzioneve në të cilat kishin arritur raportet e sipërpërmendura.

6. Në këtë drejtim është administruar dosja gjyqësore civile me referencat përkatëse e trajtuar në mënyrë të detajuar në komponentin e kriterit profesional.

7. Mbi konkludimet e raportit të DSIK-së, subjektit i është kërkuar të japë shpjegimet lidhur me konkludimet e raportit të DSIK-së.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

8. Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka prapësuar se: *“Konkluzioni i paraqitur nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, për papërshtatshmërinë time, nuk është i bazuar në asnjë provë, indicie dhe në asnjë të dhënë tjetër, se ku konsistojnë veprimet e mia në dy çështjet e referuara, që përbëjnë veprime korruptive. Nga dokumentacioni që më është vënë në dispozicion prej Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, konstatoj se në Raportin e paraqitur prej DSIK-së, nr. *** prot., datë 3.3.2021, nuk referohen konkretisht çështjet, por informacioni është dhënë në mënyrë të përgjithshme.*

*Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka paraqitur një informacion tërësisht të pasaktë dhe kjo rezulton nga përmbajtja e Raportit nr. *** prot., datë 3.3.2021, ku citohet se gjatë vitit 2017 dhe 2018, unë jam përfshirë në veprimtari të kundërligjshme, si gjyqtare stazhiere. Sqarohet se unë jam caktuar të kryej praktikën profesionale pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për periudhën 20 nëntor 2015 – 30 qershor 2016, me Dekretin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, nr. 9326, datë 20.11.2015. Në vijim, prej Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me vendimin nr. ***, datë 20.1.2017, jam emëruar ‘Magjistrat’ dhe, me vendimin datë 10.2.2017, jam caktuar në pozicionin e gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Pra, për periudhën që DSIK-ja referon edhe pse cilësohem prej saj gjyqtare stazhiere, unë nuk e kam pasur këtë status.*

*Për sa i përket periudhës gjatë së cilës kam kryer stazhin profesional në Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, bëj me dije se nga Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në zbatim të nenit 160 të ligjit 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë”, përpara se unë të caktohesha në pozicionin e gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës (vendim i datës 10.02.2017), është mbajtur relacioni nr. *** prot., datë 7.2.2017, me të gjitha verifikimet e kryera në institucionet përkatëse për kriterin e pastërtisë së figurës dhe pasurisë. Në përmbajtje të relacionit, citohet shkresa nr. ***prot., datë 25.1.2017, e Shërbimit Informativ Shtetëror, ku pasqyrohet se nuk ka të dhëna që të pengojnë emërimin tim në detyrë. Praktika dokumentare e mbajtur nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë është depozituar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bashkëlidhur shkresës protokolluar me nr. *** prot., datë 25.11.2019, me të cilën është kërkuar përjashtimi nga procesi i rivlerësimit kalimtar.*

*Duke qenë se stazhi profesional, kryhet gjatë vitit të 3-të të Shkollës së Magjistraturës, veprimtaria ime gjatë kësaj periudhe, si gjyqtare stazhiere është kontrolluar edhe nga Këshilli Pedagogjik pranë kësaj shkolle. Në bazë të neneve 9 dhe 20 të ligjit nr. 8136, datë 31.7.1996, ‘Për Shkollën e Magjistraturës’ (ligji i shfuqizuar aktualisht me ligjin nr. 115/2016), pas vlerësimit përfundimtar të kryer për të tria vitet, jam diplomuar pranë kësaj shkolle, sipas shkresës nr. *** prot., datë 29.7.2016, e Shkollës së Magjistraturës “Informacion mbi vlerësimin e kandidatëve për magjistratë të vitit të tretë, që kanë ndjekur Shkollën e Magjistraturës gjatë periudhës tetor 2013 – qershor 2016.”*

Informacioni i paraqitur nga DSIK-ja është tërësisht i pasaktë, pasi nga ana e saj referohet për përfshirjen time në veprimtari të kundërligjshme, në një çështje penale të vitit 2018. Theksoj se prej datës 10.2.2017 që jam caktuar në pozicionin e gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me Vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, deri në datën 31.7.2019, unë kam qenë e caktuar si gjyqtare në seksionin civil-tregtar dhe nuk kam gjykuar çështje penale. Me Urdhrin e Këshillit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, datë 31.7.2019, është vendosur kalimi im, pranë seksionit penal (edhe si gjyqtare pranë seksionit penal për të miturit në konflikt me ligjin) dhe pas këtij momenti kam gjykuar çështje penale.

Informacioni i paraqitur nga DSIK-ja është i pabazuar, kontradiktor, i pasaktë, por edhe alogjik, pasi sipas Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, unë jam përfshirë në veprimtari korruptive gjatë kohës që kam kryer stazhin profesional, periudhë e cila ka kaluar në kontrollin e disa institucioneve para se unë të caktohesha në pozicion dhe më pas nuk ka asnjë të dhënë tjetër.

Në nenin 38/1 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se: “1. Kontrolli i figurës zhvillohet bazuar në prova të sakta, në informacione konfidenciale, si dhe informacione të tjera të disponueshme”, ndërkohë në raportin e paraqitur nga DSIK-ja referohet për dyshime të arsyeshme, të pabazuara në asnjë provë

apo indicie, të cilat parë në raport me informacionet e tjera të cilat janë tërësisht të pasakta dhe kontradiktore, vlerësoj se edhe konkluzioni i paraqitur në lidhje me figurën time, është absolutisht i pa bazuar dhe jo i vërtetë.

*Në lidhje me çështjen civile, të zgjidhur prej meje me vendimin nr***, datë 8.2.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me palë paditëse: B.D., i paditur: OSHEE, person i tretë: Avokatura e Shtetit, me objekt: shpërblim dëmi, kopja e dosjes të së cilës është administruar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, sqaroj se ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës, me ndryshim të pjesshëm, me vendimin nr. ***, datë 22.11.2018. Për këtë çështje kam dhënë shpjegimet përkatëse, për të cilat jam e bindur se Komisioni do t'i vlerësojë ato me objektivitet dhe në raport edhe me shpjegimet që kam paraqitur për kriterin e pastërtisë së figurës”. Subjekti ka depozituar dokumentacionin¹⁷ mbështetës në prapësimet e saj.*

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

9. Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit¹⁸ të administruar, konkludoi se; (i) dyshimet i referoheshin një çështje civile të gjykuar nga subjekti në vitin 2017, e trajtuar më poshtë në kriterin profesional për të cilën nuk u konstatuan problematika; (ii) identifikimi i subjektit në gjykimin e çështjes civile si stazhiere në vitin 2017 nuk qëndron, pasi subjekti në këtë kohë kishte marrë emërimin si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Nisur nga fakti se: (i) u identifikua vetëm një çështje e gjykuar nga subjekti, konkretisht ajo e vitit 2017; (ii) subjekti në vitin 2018 kishte gjykuar vetëm çështje civile, sikurse konfirmohet nga shpjegimet e saj, por edhe me Vendimin e Këshillit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr*** prot., datë 31.7.2019, “Për shpërndarjen e gjyqtarëve në seksione dhe trupa gjykues”, qartazi provohet se konkluzionet e DSIK-së, se dyshimet për korrupsion në më shumë se një rast, pra, në mënyrë të përsëritur, nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, trupi gjykues, nën analizën ligjore dhe rrethanat faktike, çmon se dyshimet e ngritura për veprime korruptive kundrejt subjektit nuk janë të mbështetura në prova dhe, për rrjedhojë, nuk gjen vend zbatimi i dispozitave ligjore për masë penalizuese lidhur me këtë kriter.

Trupi gjykues arrin në këtë konkluzion edhe për sa kohë nga hetimi i tij, nuk evidentoi ndonjë indicie apo fakt tjetër që mund të mbështeste këto dyshime dhe, si rrjedhojë e këtij vlerësimi, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Besjana Garxenaj, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti¹⁹ për këtë komponent është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

¹⁷ Shkresë nr. ***prot., datë 29.7.2016, e Shkollës së Magjistraturës, “Informacion mbi vlerësimin e kandidatëve për magistratë të vitit të tretë, që kanë ndjekur Shkollën e Magjistraturës gjatë periudhës tetor 2013 – qershor 2016; relacion nr. ***, datë 7.2.2017, i Këshilli i Lartë i Drejtësisë; vendim nr. ***, datë 20.1.2017, i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për emërimin tim “Magjistrat”; dhe vendim i Këshillit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, datë 31.7.2019, për shpërndarjen e gjyqtarëve në seksion dhe trupa gjykues.

¹⁸ Referuar shkresës së DSIK-së e nivelit “sekret”.

¹⁹ Nr. ***, datë 11.9.2020, të KLGj-së.

Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësi profesionale;
- b) aftësi organizative;
- c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale;
- ç) aftësi personale dhe angazhimit profesional.

Gjithashtu është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (1) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore²⁰ të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (2) pesë dosjeve gjyqësore²¹ të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; si dhe në të dhënat nga burimet arkivore të KLGj-së.

ANALIZA E GJETJEVE

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit Besjana Garxenaj ka aftësi të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Ajo njeh mirë parimet e përgjithshme të së drejtës e të procesit të rregullt ligjor dhe i zbaton në praktikë, duke përdorur në disa raste referenca nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë (shihni dosjet 3, 4 dhe 5).

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se përgjithësisht gjyqtarja identifikon normën materiale të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në çështjet civile të analizuara është konstatuar se vendimi gjyqësor përmban referenca ligjore, duke dhënë edhe arsyet e zgjidhjes së çështjes (shihni dokumentet 1 dhe 3 dhe dosjet 1, 2 dhe 3). Në çështjet penale i kushton rëndësi të gjithë elementëve të veprës penale, si

²⁰ Dokumenti 1 - vendimi civil nr. ***, datë 1.4.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket paditëses H. L., me të paditur shoqëria “Ujësllës - Kanalizime Tiranë” sh.a., me objekt “konstatimin e zgjidhjes së menjëherëshme e të pajustificuar të kontratës së punës, detyrimin për dëmshpërblim me 12 paga mujore për zgjidhje të menjëherëshme e të pajustificuar të kontratës së punës, etj.”; dokumenti 2 - vendimi penal nr. ***, datë 4.5.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket të pandehurit H. B., i akuzuar për veprën penale “vjedhje e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, të parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal; dokumenti 3 - vendimi civil nr. ***, datë 27.7.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket paditëses Drejtorja e Shërbimit të Trupit Diplomatik, me të paditur E. R., me objekt “detyrimin e të paditurit të përmbushë detyrimin që rrjedh nga kontrata e qirasë e të paguajë pagesën e qirasë për periudhën tetor-nëntor-dhjetor 2015 dhe 13 ditë të muajit janar 2016, në vlerën 605,6 euro si dhe kamatëvonesat”.

²¹ Dosja 1 - çështja civile nr.***regj., datë 19.1.2016, që i përket paditësit S.S., me të paditur Ujësllës-Kanalizime Tiranë sh.a., me objekt “Konstatimin e zgjidhjes së menjëherëshme e të pajustificuar të kontratës së punës, detyrimin për pagimin e dëmshpërblimeve”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 30.3.2016; dosja 2 - çështja civile nr. *** regj., datë 10.3.2016, që i përket palës paditëse shoqëria “*****” sh.p.k., kundër të paditurit R. S., me objekt “detyrimin e të paditurit t’i kthejë paditësit shumën 400.000 lekë për moszbatim të aktmarrëveshjes dhe pagimin e dëmshpërblimit”, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 7.6.2016; dosja 3 - çështja civile nr. ***regj., datë 21.1.2016, që i përket paditësit E. M., me të paditur S. M., me objekt “zgjidhjen e martesës, lënien e fëmijës për rritje dhe edukim, etj.”, e përfunduar me vendimin nr.***, datë 15.3.2016; dosja 4 - çështja penale nr. *** regj., datë 11.3.2016, që i përket kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë kundër të pandehurit A. H., i akuzuar për veprën penale “vjedhje të energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, të parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 27.4.2016; dosja 5 - çështja administrativo-penale me nr. *** regj., datë 18.5.2016, që i përket personit nën hetim T.V., me objekt “çaktimin e masës së sigurimit ‘arrest në burg’”, parashikuar në nenin 238 të Kodit të Procedurës Penale, e përfunduar me vendimin nr. *** akti, datë 19.5.2016.

dhe ndalet me kujdes te dënimi penal dhe alternativat e tij (shihni dokumentin 2 dhe dosjen 4). Gjithashtu, subjekti ka njohuri edhe për masat e sigurimit (shihni dosjen 5).

Znj. Besjana Garxenaj ka njohuri të mira të procedurave të gjykimit, në raport me llojin e çështjeve gjyqësore penale apo civile që ka shqyrtuar, njeh aspektet e procesit të rregullt ligjor në drejtim të pjesëmarrjes së palëve në gjykim, të kontradiktoritetit e deri tek arsyetimi i vendimit gjyqësor.

Së fundmi, duhet evidentuar se përgjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, për gjyqtaren Besjana Garxenaj nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin e KLD-së dhe sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore nuk rezulton të ketë ardhur ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë propozuar në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë ndonjë masë për procedim disiplinor.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit Besjana Garxenaj ka aftësi të mira në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore të hartuara prej saj, në përgjithësi, janë të qarta dhe të kuptueshme, por ndonjëherë edhe të gjata. Në përgjithësi, respekton rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe i ka përdorur të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten në gjatësi normale, janë të kuptueshme dhe me referenca ligjore.

Struktura e vendimeve përfundimtare është e qëndrueshme dhe e standardizuar, duke i shërbyer funksionit të qartësisë së argumentimit ligjor. Vendimet përfundimtare të saj plotësojnë, sipas rastit, kërkesat e legjislacionit procedural civil (shihni dokumentet 1 dhe 3 dhe dosjet 1, 2 dhe 3) apo kërkesat e legjislacionit procedural penal (shihni dokumentin 2 dhe dosjet 4 dhe 5). Në një rast u konstatua që në pjesën hyrëse të vendimit mungonin të pasqyruara emri i përfaqësuesit ligjor të personit nën hetim në mungesë dhe kërkesa përfundimtare e tij (shihni dosjen 5).

Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës, në raport me pretendimet e ngritura nga palët. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore dhe rezulton e plotësuar me pjesë edhe nga jurisprudenca unifikuuese e Gjykatës së Lartë. Një konstatim i punës së saj është jo vetëm fokusimi i arsyetimit të vendimit te thelbi i çështjes dhe konkretizimi sipas rastit në mosmarrëveshje, por edhe përdorimi i fjalive të përgjithshme apo arsyetim i tepërt mbi çështje të konsoliduara nga praktika dhe doktrina.

Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Nuk është identifikuar asnjë rast nga tri dokumentet ligjore dhe pesë dosjet e vëzhguara, që të jetë cenuar vendim nga Gjykata e Apelit ose Gjykata e Lartë, për shkak të procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në dispozitivin e vendimit, në të gjitha rastet e vëzhguara, është konstatuar se disponohet për shpenzimet procedurale/gjyqësore, si dhe tregohet e drejta e ankimit për palët.

Gjithashtu, në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme. Në çdo rast, vendimet e ndërmjetme jepen me tekst të qartë arsyetimi, duke referuar shkakun dhe bazën ligjore.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit Besjana Garxenaj, në periudhën e rivlerësimit, 8.10.2013 - 8.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtares stazhiere në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, njëkohësisht në dhomën civile e penale.

Ajo ka deklaruar se gjatë tri viteve të fundit i janë caktuar gjithsej 134 çështje, ka përfunduar gjithsej 134 çështje për tre vjet, si dhe nuk ka mbartur në vitin 2017 asnjë çështje të vitit 2016. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna është 100 %.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Gjatë gjykimit, gjyqtarja identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra e vendime të ndërmjetme për realizimin e tyre. Zhvillon sipas ligjit procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, që nga çelja e seancës, te pretendimet fillestare të palëve, administrimi i provave, diskutimet përfundimtare të palëve e deri te shpallja e vendimit.

Në gjykimet penale, data për seancën e parë është caktuar pas më shumë se 10 ditëve, siç është parashikuar nga neni 333/2 i Kodit të Procedurës Penale. Seancat gjyqësore janë caktuar gjithmonë duke respektuar afatin 15-ditor të parashikuar nga neni 342/2 i Kodit të Procedurës Penale. Në të dyja rastet e dosjeve penale u konstatua se vendimi për caktimin e seancës së parë është marrë nga gjyqtarja brenda afatit maksimal 10-ditor, të parashikuar nga neni 333/1 i Kodit të Procedurës Penale (shihni dosjet 4 dhe 5).

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se kanë qenë të rregullta dhe të plota nga ana formale. Për veprimet e kryera në seancë përgatitore apo gjyqësore është mbajtur procesverbal gjyqësor, bazuar në dispozitat procedurale civile (shihni dosjet 1, 2 dhe 3) ose ato penale (shihni dosjet 4 dhe 5). Në çdo dosje civile të vëzhguar gjendet vendimi për caktimin e seancës përgatitore, aktet e njoftimit të palëve, kërkesat me shkrim të tyre dhe provat e paraqitura. Të gjitha procesverbalet e seancës përgatitore dhe ato gjyqësore të administruara në dosje, rezulton se janë të plota, me të gjitha të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera, me përjashtim të dosjes 5, në të cilën u konstatua se mungonin gjeneralitetet e personit nën hetim, sipas nenit 245/a të Kodit të Procedurës Penale. Por, të gjitha procesverbalet rezultojnë të nënshkruara nga sekretarja gjyqësore dhe nga gjyqtarja, sipas kërkesave të nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 345 të Kodit të Procedurës Penale. Procesverbali gjyqësor në formatin letër dokumenton kohën dhe vendin, si dhe veprimet që kryhen në seancë. Konstatohet se asnjë nga seancat gjyqësore të pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka rezultuar e dokumentuar me regjistrim *audio*, në kundërshtim me funksionin e transparencës dhe të solemnitetit në gjykim. Çmohet se lidhur me këtë ka ndikuar edhe gjendja e infrastrukturës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me numrin e pamjaftueshëm të sallave të gjykimit.

Dosjet kanë rezultuar të administruara rregullisht dhe janë sistemuar në mënyrë kronologjike, në fillim aktet e palëve ndërgjyqëse e më pas aktet e gjykatës, me përjashtim të dosjes 3 që nuk ishte sistemuar në mënyrë kronologjike. Megjithatë, të gjitha dosjet rezultojnë të inventarizuara rregullisht, duke u bërë lehtësisht të shfrytëzueshme për palët.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016, për gjyqtaren Besjana Garxenaj nuk është paraqitur asnjë ankesë në

Inspektoratin e KLD-së dhe sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore nuk rezulton të ketë ardhur ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë propozuar në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë ndonjë masë për procedim disiplinor. Edhe nga vëzhgimi i pesë dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës Besjana Garxenaj.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Besjana Garxenaj dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Besjana Garxenaj. Në pesë dosjet e vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej dokumenteve ligjore dhe dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit Besjana Garxenaj nuk ka respektuar rregullat procedurale me pasojë cenimin e parimit të gjykatës së paanshme.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja Besjana Garxenaj komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Gjuha e përdorur në aktet e dosjeve të vëzhguara është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe e qartë, nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elemente që lidhen me paanësinë e tij. Në të gjitha rastet e vëzhguara nuk është konstatuar që ndonjë prej palëve të ketë paraqitur kërkesa për përjashtim të gjyqtarës dhe as kërkesa të gjyqtarës për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit Besjana Garxenaj për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në tetë raste, subjekti i rivlerësimit ka qenë gjyqtare e vetme për gjykimin e çështjes dhe ka bashkëpunuar me administratën gjyqësore, për të zhvilluar seancën sipas rregullave procedurale, civile dhe penale.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit Besjana Garxenaj, për shkak të funksionit të gjyqtarës së shkallës së parë, i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ajo ka marrë pjesë në 9 trajnime në Shkollën e Magjistraturës, gjithsej 13 ditë të formimit vazhdues. Lënda e trajnimeve, ku ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarës së shkallës së parë, në përbërje të dhomave civile e penale.

Subjekti i rivlerësimit Besjana Garxenaj ka deklaruar se nuk ka marrë pjesë në aktivitete të tjera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës.

C/I. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Komisioni pasi u njoh dhe analizoi të gjithë dokumentacionin e depozituar nga KLGj-ja mbi të cilin edhe është hartuar raporti i vlerësimit profesional për këtë subjekt, ka konstatuar si vijon:

a. Në tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të llojit vendim gjyqësor.

a/i Për dokumentet nr.1 dhe 3²² nuk pasqyrohen të dhëna nëse kundër vendimeve është ushtruar ankim nga palët ndërgjyqëse.

a.ii Në dokumentet nr. 2 (vendim penal) dhe 3 (padi civile) nuk pasqyrohen të dhëna, për të konkluduar mbi afatin e gjykimit, për shkak se nuk pasqyrohet data e regjistrimit të kërkesës së organit të prokurorisë apo padisë civile dhe, për pasojë, sikurse ka konkluduar KLGj-ja në raportin e saj, edhe Komisioni në këto rrethana, nuk mundi të konkludojë nëse këto çështje janë shqyrtuara brenda afatit standard 6-mujor të gjykimit, të përcaktuar nga germa “e”, e pikës 5, të vendimit të KLD-së “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

- Për sa konkludohet në gerrat a.i dhe a.ii, subjektit iu kërkua të japë shpjegime dhe të depozitojë dokumentacionin mbështetës.

- Në lidhje me tri dokumentet e llojit “vendim gjyqësor” subjekti ka depozituar shkresën²³ e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ku pasqyrohet data e regjistrimit të çështjeve, data e vendimit, si dhe ushtrimi i së drejtës ankimore.

- Trupi gjykues, nga dokumentacioni i depozituar dhe nga të dhënat e rezultuara në to, vëren se:

- Gjykimi për të tria vendimet e përzgjedhura nga subjekti është zhvilluar brenda afatit 6- mujor të gjykimit, të përcaktuar nga germa “e”, e pikës 5, të vendimit të KLD-së “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore” ndërsa,
- Është ankimuar vetëm vendimi që i përket dokumentit të parë, për të cilin Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi.

- Nën këto fakte, pra për sa kohë çështjet janë shqyrtuar e gjykuar në afatin e arsyeshëm të ligjësuar nga organi kompetent, trupi gjykues nuk sheh ekzistencën e ndonjë problematike që ndikon në vlerësimin e nivelit profesional të subjektit.

b. Komisioni, sa i përket pesë dosjeve gjyqësore, përgjithësisht, nuk konstatoi problematika procedurale lidhur me afatin e gjykimit të çështjeve prej regjistrimit dhe deri në përfundimin e tyre apo edhe me dorëzimin e vendimeve. Njëkohësisht nuk u konstatuan problematika në strukturimin e vendimeve, përdorimin e legjislacionit të fushës në secilin rast, inventarizimin e akteve të administruara në dosjet gjyqësore, etj. Në këto dosje u konstatua se janë ankimuar tri prej tyre (vendimet që i përkasin dosjes 1, 2 dhe 3). Në të tria rastet u vërejt se Gjykata e Apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit.

b.i Megjithëse në raportin e vlerësimit Grupi i Punës ka konstatuar por edhe ka argumentuar lidhur me mosdokumentimin me regjistrim audio të disa seancave, si veprim jo në funksion të transparencës dhe të solemnitetit në gjykim, subjektit iu kërkua të japë shpjegime më të zgjeruara për shkaqet dhe arsyet që nuk kanë lejuar zhvillimin e seancave me regjistrim audio.

²² Referuar vendimeve gjyqësore të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në kuadër të vlerësimit profesional, të cituara në titullin “tri dokumentet ligjore”.

²³ Nr. *** prot., datë 8.4.2021.

- Subjekti, në parashtrimet e saj, ndër të tjera, ka paraqitur arsyet që nuk kanë lejuar zhvillimin e seancave me regjistrim *audio*, për pesë dosjet gjyqësore të administruara për vlerësimin profesional, të përzgjedhura me short.

Më konkretisht, subjekti ka sqaruar se:

- ka qenë evidente mungesa e sallave të gjykimit, ku mundësohej regjistrimi *audio*;
- sallat e gjykimit me regjistrim *audio* kanë qenë të planifikuara sipas një kalendari të caktuar për t'u shfrytëzuar nga gjyqtarët që ushtronin detyrën në të;
- ka qenë në kohën e stazhit dhe se stazhierët nuk kanë qenë të caktuar në këtë kalendar;
- mungesa e infrastrukturës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, shkak që nuk kushtëzohej prej vullnetit të saj dhe tej çdo mundësie.

- Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të subjektit, çmon se ato janë të plota, të argumentuara dhe, për pasojë, nuk diktojnë problematika ndaj subjektit të rivlerësimit.

➤ Sikurse është reflektuar më sipër në kontrollin e figurës, Komisioni, nisur nga konkludimet e bëra prezent në raportin e DSIK-së, kërkoi për të administruar dosjen gjyqësore civile në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Më tej, ka analizuar dokumentacionin e administruar në të, në këndvështrim të vlerësimit të aftësive profesionale nën kontekstin e provueshmërisë së konkludimeve të raportit.

- Çështja e administruar i përket padisë me palë ndërgjyqëse, paditëse: B. D., i paditur: OSHEE-ja, person i tretë: Avokatura e Shtetit, me objekt *shpërblim dëmi*. Me zëvendësim është kërkuar ndryshimi i palës paditëse nga bashkëshortja e paditësit, N. D., për shkak se aktiviteti ka qenë i regjistruar në emër të saj.

- Nga aktet e administruara në dosje rezulton se:

- Çështja gjyqësore është regjistruar në datën 3.5.2017 dhe ka përfunduar me vendimin gjyqësor nr. ***, datë 8.2.2018, me të cilin është vendosur pranimi pjesërisht i padisë dhe njëkohësisht është lëshuar edhe urdhërezekutimi për detyrimin e OSHEE-së për t'i paguar paditëses N. D. dëmin pasuror të shkaktuar nga ngjarja e datës 29.1.2017 (djegie nga zjarri i kioskës) në shumën 2.358,000 lekë, si dhe fitimin e munguar, përlloritur nga data 1.2.2017 – 31.10.2017, në shumën 442.000 lekë. Sipas materialit të dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës²⁴ rezulton se vendimi është ankimuar dhe Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr***, datë 21.6.2019, ka vendosur ndryshimin e vendimit të shkallës së parë sa i përket vlerës së shumës që sipas vendimit detyrohet OSHEE-ja të dëmshpërblejë paditësin. Aktualisht, çështja ndodhet në Gjykatën e Lartë.

- Në datën 5.5.2017 (pra, dy ditë pas regjistrimit) është bërë kalimi i çështjes në seancë përgatitore. Subjekti i rivlerësimit ka disponuar me vendimin përkatës.

Rrethanat e çështjes objekt gjykimi

Sipas padisë, paditësi ka parashtruar se ka qenë pronar i një kioske me aktivitet agjenci udhëtimesh (prerje bileta udhëtimesh), se kioskën e ka ndërtuar me leje ndërtimi, se është furnizuar me energji elektrike të lidhur sipas të gjitha rregullave në fuqi me institucionin përkatës (OSHEE) dhe se për shkak të luhatjes së energjisë elektrike i është djegur kioska, si pasojë e së cilës është kërkuar edhe dëmi i shkaktuar nga pala e paditur, OSHEE.

²⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 2.2.2021.

Në dosje është administruar edhe një kërkesë për zëvendësim të palës paditëse, ku dhe është kërkuar masa e shpërblimit për fitimin e munguar.

Mbi legjitimitetin e ndryshimit të ndërgjyqësisë është administruar edhe ekstrakti i QKB-së, nga ku vërehet se aktiviteti ka qenë i regjistruar në emër të bashkëshortes së paditësit, N. D. .

Në dosje është administruar edhe autorizimi për përfaqësimin e OSHEE-së në proces, me cilësinë e palës së paditur.

Në dosje është administruar praktika e kallëzimit penal nr***, datë 1.2.2017, e cila ka përfunduar me vendim mosfillimi të procedimit penal. Në arsyetimin e vendimit trajtohet edhe ekzistenca e aktekspertimit piroteknik, si dhe konkluzioni i këtij të fundit ku cilësohet se nuk ekzistojnë dyshime për veprime që kanë pasur qëllim vënien e zjarrit në kioskën në pronësi të shtetasit D., por zjarri ka rënë si pasojë e shkëndijës elektrike.

Në dosje është administruar edhe aktekspertimi (referojuni faqes nr. 103) i kryer për llogari të procesit gjyqësor, nga inxhinier elektrik H.P. . Në akt, në konkluzion është rezultuar kryesisht mbi shkaktimin e djegies së objektit, pra mbi arsyet e rënies së zjarrit. Prezenca e ekspertit pasqyrohet në procesverbalin gjyqësor të datës 13.10.2017 (referojuni faqes së numërtuar nr. 341).

Në dosje është administruar një tjetër aktekspertimi (referojuni faqes nr. 122) përgatitur nga studio B., në të cilin kryesisht trajtohet mbi vlerën e dëmit të shkaktuar, duke u konkluduar në një vlerë të caktuar për t'u dëmshpërblyer paditësi.

Në dosje është administruar edhe një shtesë e aktekspertimit të përgatitur po nga studio B. .

Konstatime pas verifikimit:

1. Sipas kërkesës për fitimin e munguar (referojuni faqes nr. 13) thuhet se padia është depozituar në datën 1.2.2017, ndërsa rezulton e regjistruar me nr. *** akti, datë 3.5.2017.
2. Sipas procesverbalit datë 24.1.2018, pala paditëse (përfaqësuesi ligjor i shtetasit B. D.) ka kërkuar kohë të shkurtër për të rishikuar ndërgjyqësinë (referojuni faqes 390).

Subjektit i është kërkuar të shpjegojë mbi veprimet e kryera me padinë, në harkun kohor 1.2.2017 – 3.5.2017, si dhe lidhur me faktin se dukej se nuk pasqyrohej me procesverbal (akt procedural) zëvendësimi i ndërgjyqësisë. Gjithashtu, subjektit iu kërkua të depozitojë çdo dokumentacion mbështetës të vlerësuar prej saj.

Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, në parashtrimet e saj në lidhje me çështjen e trajtuar në funksion të kriterit të figurës, me palë paditëse N.D., i paditur OSHEE-ja sh.a., person i tretë Avokatura e Shtetit, ka shpjeguar se çështja është dorëzuar fizikisht nga paditësi më 3.5.2017 dhe se është regjistruar në datën 4.5.2017, ndërsa data 1.2.2027, e cilësuar në kërkesën për fitimin e munguar është thjesht lapsus.

Subjekti ka depozituar shkresën²⁵ e Gjykatës së Lartë me të cilën i vihet në dispozicion një kopje e dosjes gjyqësore, çka nënkupton vijimin e procesit gjyqësor të çështjes në këtë gjykatë.

Subjekti ka shpjeguar edhe mbi pranimin e kërkesës për shtim të objektit të padisë lidhur me fitimin e munguar, për të cilën qartëson se i është referuar nenit 486 të Kodit të Procedurës Civile.

²⁵ Nr. *** prot., datë 6.4.2021.

Në lidhje me konstatimin e Komisionit se dukej se nuk pasqyrohej me procesverbal (akt procedural) zëvendësimi i ndërgjyqësisë, subjekti ka sqaruar se është shprehur me vendim të ndërmjetëm për pranimin e zëvendësimit të ndërgjyqësisë, fakt i pasqyruar në përmbajtje të procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 2.2.2018²⁶.

Trupi gjykues, në analizë të secilit sqarim të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se qëndron saktësimi i bërë lidhur me paraqitjen e padisë në datën 3.5.2017²⁷ dhe, që për pasojë, regjistrimi i saj sigurisht është më pas, në datën 4.5.2017, veprim i cili bën logjikë në kronologji të depozitimit dhe, më tej, të regjistrimit të aktit, çka nënkupton se citimi nga paditësi se depozitimi është bërë më 1.2.2027, është thjesht dhe vetëm lapsus në të shprehur.

Po ashtu, nga verifikimi i procesverbalit të seancës datë 2.2.2018, trupi gjykues konstaton se në të pasqyrohet vendimi i pranimit mbi ndryshimin e ndërgjyqësisë, veprim procedural ky i kryer sipas ligjit në shqyrtimin dhe gjykimin e një çështjeje me palë ndërgjyqëse.

Në të tilla kushte, në tërësi, për sa kohë u saktësuan konstatimet e natyrës procedurale, për sa kohë Komisioni nuk ka kompetencë në shqyrtimin e themelit të çështjes për të mos cenuar jo vetëm logjikën e gjyqarit, por edhe rolin e gjykatave të shkallëve më të larta, të cilat arsyetojnë ligjshmërinë e vendimeve, trupi gjykues nuk vëren problematika në këtë çështje gjyqësore që mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit dhe, për pasojë, as edhe në provueshmërinë e konkludimeve të raportit të DSIK-së.

Në lidhje me denoncimet²⁸ e paraqitura në Komision për subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, për tre prej tyre ka rezultuar si vijon:

1. Denoncim²⁹ i shtetasit S.T.

1.1 Denoncuesi, në denoncimin e tij, pretendon për shkelje të kryera nga subjekti i rivlerësimit lidhur me gjykimet civile me objekt pronësor, në të cilët ka qenë palë ndërgjyqëse. Në rastin konkret denoncuesi, megjithëse ankohet thujtse ndaj 27 subjekteve të rivlerësimit për subjektin objekt i hetimit administrativ, ankohet ndaj vendimit nr. ***, datë 28.4.2017, sipas të cilit z. S.T. nuk legjitimohet që të bëjë ankim ndaj gjyqarit P. Ç. dhe ndaj vendimit nr. ***, datë 21.3.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Gjithashtu, denoncuesi ankohet se ka kërkuar edhe përjashtimin e subjektit të rivlerësimit nga gjykimi i çështjes së tij pronësore, por kërkesa nuk është pranuar.

Denoncuesi nuk ka depozituar dokumentacion mbështetës mbi parashtrimet e tij ndaj subjektit të rivlerësimit.

1.2 Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të shpjegojë lidhur me pretendimet e denoncuesit, si dhe të depozitojë vendimmarrjet e dhëna prej saj (nëse ka pasur të tilla) me këtë palë ndërgjyqëse, si dhe të tregojë mbi statusin aktual të tyre (të vendimeve).

²⁶ I administruar në dosjen gjyqësore, depozituar nga subjekti me shkresën nr. ***prot., datë 6.4.2021, të Gjykatës së Lartë.

²⁷ Konfirmuar në vulën e kryesekretarisë gjyqësore në kërkesëpadi, akt i administruar në kopjen e dosjes gjyqësore, përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 6.4.2021, depozituar nga subjekti në prapësime.

²⁸ Nga ku, dy denoncime kanë ardhur përkatësisht, njëri ditën e seancës dëgjimore dhe tjetri në fund të ditës, datë 19 prill 2021, të cilat janë analizuar në procesverbalin e datës 20.04.2021.

²⁹ Nr. *** prot., datë 28.7.2020.

1.3 Subjekti, në parashtrimet e saj, ndër të tjera, ka shpjeguar se është shprehur me vendim për “disponim ankimi” paraqitur nga shtetasi S.T. . Subjekti ka shpjeguar se për çështjen civile pronësore (për themelin e saj), gjykata kishte shpallur moskompetencën dhe se ky shtetas kishte paraqitur ankim, ndërsa rezultonte të mos ishte palë ndërgjyqëse. Subjekti ka qartësuar se në vendimarrjen e saj është bazuar në nenin 450/c të Kodit të Procedurës Civile dhe se vendimi është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. ***, datë 12.9.2017.

Po ashtu, subjekti ka qartësuar se edhe pas ezaurimit të çështjes së kompetencës në shkallët më të larta të gjyqësorit, themeli i çështjes me short elektronik kishte rënë tek ajo, por në kushtet e mësipërme kishte paraqitur dorëheqjen që i ishte miratuar nga drejtuesi. Subjekti ka depozituar dokumentacionin³⁰ mbështetës të shpjegimeve të tij.

1.4 Në tërësi, në analizë të shpjegimeve dhe dokumentacionit të administruar, trupi gjykues vëren se subjekti ka ndërmarrë hapat e duhur proceduralë në gjykimin e ankimit të depozituar nga një person, i cili nuk rezultonte të ishte palë ndërgjyqëse dhe që, për pasojë, bazuar në nenin 450/c³¹ të Kodit të Procedurës Civile, dispozitë e cituar dhe përdorur me të drejtë nga subjekti, ai nuk mund të dispononte me ankim. Po ashtu, trupi gjykues vëren se subjekti me të drejtë është dorëhequr në shortin e radhës lidhur me themelin e çështjes, për shkak se ishte shprehur më parë pikërisht lidhur me ankimin e bërë ndaj çështjes së kompetencës së gjykimin.

2. Denoncim³² i shtetasit A. H.

2.1 Denoncuesi ankohet për shkelje procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit lidhur me procesin gjyqësor që ka iniciuar për të kundërshtuar aneksin e një kontratë sipërmarrje lidhur me një shoqëri ndërtimore. Në këtë kontekst ai pretendon se nuk i është kërkuar deklarata e mbrojtjes lidhur me kundërpadinë e depozituar nga pala e paditur, i është refuzuar pranimi i disa dokumenteve, të cilat ka kërkuar t’i depozitojë në seancë përgatitore dhe se mbi këtë mospranim gjyqtarja (pretendon denoncuesi) nuk është shprehur. Gjithashtu pretendon se pa kërkesën e tij gjykata ka vendosur të marrë ekspert dhe se më tej kur ka kërkuar t’i parashtrijë këtij të fundit një problem lidhur me padinë e depozituar, gjykata e ka refuzuar.

Denoncuesi ka depozituar kërkesën datë 17.7.2019, për sqarime plotësuese për ekspertin, kërkesën nr. *** prot., datë 17.7.2019, për depozitim të një opinion të vlerësimit të ekspertëve, si dhe anekskontratën objekt gjykimi.

Denoncuesi nuk sqaron nëse çështja ka përfunduar së gjykuari.

2.2 Për sa më sipër, subjektin i është kërkuar të japë shpjegime duke u përqendruar në pretendimet e denoncuesit, i cili ka specifikuar edhe bazueshmëritë ligjore të kërtimeve/pretendimeve të tij, si

³⁰ Shkresat nr. ***prot., datë 2.4.2021 dhe nr. ***, datë 7.4.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; vendim nr. ***, datë 21.3.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për shpalljen e moskompetencës; vendim nr. ***, datë 18.1.2018, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; vendimin nr. ***, datë 28.4.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me shënimin se ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. ***, datë 12.9.2017, të Gjykatës së Apelit Durrës; fletë regjistrimi për rekursin e ushtruar në Gjykatën e Larë; informacion mbi statusin aktual të çështjes civile me palë paditëse D. T. etj.; informacion mbi kërkesat e regjistruara në Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me kërkesën S. T.; vendim datë 9.6.2020 e zëvendëskryetarit z. M. K., të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për pranimin e kërkesës për heqjen dorë nga gjykimi dhe kërkesa e paraqitur prej meje për heqje dorë nga gjykimi i çështjes civile, bashkëlidhur aktet mbi të cilat është bazuar kërkesa.

³¹ Në nenin 450 të Kodit të Procedurës Civile thuhet shprehimisht: “Gjykata që ka dhënë vendimin nuk e pranon ankimin kur: (a) është paraqitur tej afatit të parashikuar me ligj; (b) është bërë kundër një vendimi ndaj të cilit nuk lejohet ankimi; (c) është bërë nga një person që nuk legjitimohet të bëjë ankim; (ç) është hequr dorë nga ankimi. Mospranimi mund të deklarohet në çdo shkallë gjykimi. Vendimi i mospranimit i njoftohet atij që ka bërë ankim. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim i veçantë”.

³² Nr. *** prot., datë 1.12.2020.

dhe të depozitohet dokumentacionin përkatës në mbështetje të shpjegimeve. Gjithashtu, subjektit i është kërkuar të qartësojë mbi statusin aktual të kësaj çështjeje gjyqësore.

2.3 Subjekti, ndër të tjera, në parashtrimet e tij, ka shpjeguar se çështja civile me palë paditëse/i kundërpaditur A. H., i paditur/kundërpaditës shoqëria “****” sh.p.k., me objekt të kërkesëpadisë “Kërkohet respektimi i kontratës së sipërmarrjes nr. ***, datë 9.10.2012, duke shfuqizuar aneks kontratën nr. ***, datë 10.10.2018”, me objekt të kundërpadisë “Detyrimin e paditësit të kundërpaditur A. H. të përmbushë detyrimin kontraktor që rrjedh nga kontrata e sipërmarrjes nr. ***, datë 9.12.2012 dhe aneks kontratën me nr. ***, duke marrë nga shoqëria ‘****’ sh.p.k. në dorëzim si pronar i truallit me sip. 262,12 m², këto pjesë përkatëse. Shpërblimin e dëmit nga mospërmbushja e detyrimit në shumën apo vlerën 14,000 euro”, është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me nr. regj. themeltar ***, datë regjistrimi 23.1.2019 dhe është zgjidhur prej meje me vendimin nr. ***, datë 18.10.2019, në të cilin kam vendosur: “Rrëzimin e kërkesëpadisë së paditësit/të kundërpaditur A. H.; rrëzimin e kundërpadisë së palës së paditur/kundërpaditëse shoqëria ‘****’ sh.p.k...”. Vendimi nuk ka marrë formë të prerë ende, pasi është paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Durrës.

Në lidhje me pretendimin e paraqitur nga denoncuesi se nuk i është lënë afat për paraqitjen e deklaratës së mbrojtjes, subjekti ka shpjeguar se me ndryshimet e Kodit të Procedurës Civile me ligjin nr. 38/2017, në nenin 158/1 të Kodit të Procedurës Civile gjendet parashikimi: “Gjykata, pasi e vlerëson padinë pa të meta në zbatim të neneve 154/a dhe 156 të këtij kodi, i kërkon të paditurit të lëshojë deklaratën e mbrojtjes, jo më vonë se 30 ditë nga njoftimi i kërkesëpadisë. Të njëjtat rregulla zbatohen edhe në rastin e paraqitjes së padisë së ndërhyrësit kryesor ose të kundërpadisë” dhe për këtë ka vlerësuar se në këtë dispozitë përcaktohet afati maksimal 30-ditor, brenda të cilit i padituri/i kundërpadituri ka të drejtë të ushtrojë të drejtën e tij për të lëshuar deklaratën e mbrojtjes. Nëse kjo e drejtë ushtrohet më parë në kohë, gjykata merr masat për vijimin e gjykimit, pasi është e drejta absolute e palës për të shfrytëzuar të gjithë afatin ligjor ose jo. I padituri/i kundërpadituri, pasi merr dijeni për padinë/kundërpadinë mund të lëshojë deklaratën e mbrojtjes, edhe më parë se afati 30-ditor, por në çdo rast jo më vonë se 30 ditë. Ky afat fillon të ecë nga momenti kur pala merr dijeni, fakt që provohet nga dëftesa e komunikimit të padisë/kundërpadisë dhe akteve, që gjykata ia komunikon palëve (me njoftimin fillestar apo kur gjykimi zhvillohet në mungesë) ose pala merr dijeni në seancë gjyqësore, kur është i pranishëm dhe kërkimet paraqiten në seancë. Pra, paraqitja e deklaratës së mbrojtjes dhe shfrytëzimi i afatit ligjor 30-ditor për paraqitjen e saj, është tagër absolut i palëve ndërgjyqëse dhe gjykata nuk mund të detyrojë të kundërtën e asaj që palët zgjedhin. Për këtë, subjekti ka qartësuar se palës ndërgjyqëse (denoncuesit) i është dhënë e drejta e njohjes me kundërpadi, se ka shfrytëzuar afatin e lënë dhe se në seancën përgatitore të radhës është shprehur se nuk ka interes të zgjasë gjykimin dhe se është dakordësuar me pranimin për gjykim të kundërpadisë, nuk ka kërkuar më tepër kohë dhe as ka paraqitur deklaratë mbrojtjeje. Subjekti ka parashtruar edhe lidhur me pretendimet e tjera si për rastin e marrjes së ekspertit, ku jo domosdoshmërisht ky veprim gjyqësor kushtëzohet nga pëlqimi i palëve, kur është i nevojshëm për gjykimin e çështjes. Ajo, gjithashtu, ka qartësuar se vendimmarrja ka qenë tërësisht e bazuar në ligjin procedural civil dhe e kundërta, nëse do të lejohej aktekspertimi kryer privatisht prej palës paditëse, do të përbënte shkelje të procesit të rregullt ligjor, pasi ai jo vetëm që është një akt i njëanshëm, por as nuk është marrë në përputhje me rregullat e Kodit të Procedurës Civile. Subjekti ka saktësuar se të gjitha veprimet procedurale janë pasqyruar në procesverbalet e seancave gjyqësore. Ajo ka depozituar shkresën nr***prot., datë 7.4.2021, të Gjykatës së Apelit Durrës; kopje të njehsuar të dosjes gjyqësore; vendimin nr. ***,

datë 18.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe informacionin³³ mbi statusin aktual të çështjes.

2.4 Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të denoncuesit, të prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe të dokumentacionit të depozituar prej tij, çmon se shpjegimet e subjektit janë qartësuar në nivel profesional dhe janë bazuar kronologjikisht në parashikime ligjore. Vërehet se subjekti ka ndjekur të gjitha hapat procedurale dhe ligjore në veprimet gjyqësore të ndërmarra për gjykimin e çështjes. Nga ana tjetër, trupi gjykues nuk ka tagrin të reflektojë apo argumentojë situatën gjyqësore lidhur me themelin e çështjes dhe as të zëvendësojë logjikën e gjyqtarit në arsyetimin e vendimit përfundimtar apo edhe në vendimet e ndërmjetme. Njëkohësisht, palës ndërgjyqëse në çdo rast i garantohet e drejta e ushtrimit të ankimit që në këtë rast është ezauruar. Pra, një argument tjetër ligjor është edhe fakti se procesi gjyqësor vijon gjykimin në gjykatat e shkallëve më të larta dhe, për pasojë, ligjërimi i arsyetimit të vendimmarrjes është atribut i tyre.

3. Denoncim³⁴ i shtetases L. K.

3.1 Denoncuesja në denoncimin e depozituar ankohet për shkelje të etikës profesionale të subjektit të rivlerësimit dhe ka përshkruar situatën e krijuar pas përfundimit të hetimeve nga Prokuroria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në ngarkim të disa të akuzuarve, si ish - zyrtarë, nën akuzën e shpërdorimit të detyrës, për shkak të ndodhive pas tërmetit të nëntorit 2019 nga ku humbën jetën disa persona. Denoncuesja është ndalur pikërisht te gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit, pas kërkimit të organit të prokurorisë për secilin prej të akuzuarve. Denoncuesja megjithëse nuk identifikon lidhjen e saj me këtë proces, parashtron dhe pretendon se në përfundim të gjykimit, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur dy qëndrime të ndryshme, në vendimmarrje, për dy prej të pandehurve të akuzuar, nën të njëjtën akuzë dhe përkatësisht të dy në pozicione pune të njëjta tek ALUIZNI, megjithëse prokuroria *ka theksuar ajo*, kishte kërkuar masën e sigurimit personal më të rëndë ndaj të akuzuarit për të cilin subjekti ka pushuar kërkesën e organit të prokurorisë, e ndërsa për të akuzuarin tjetër për të cilin ishte kërkuar masë e sigurimit personal më e butë, ajo e arrestit në shtëpi, subjekti ka dërguar çështjen për gjykim. Znj. L. K. etiketon rastin, si dhe vendimmarrjen e subjektit, si të politizuar, për shkak të pozicionimit të secilit prej të akuzuarve në partitë politike.

Gjithashtu, denoncuesja është ankuar edhe lidhur me masën e sigurimit personal dhënë ndaj ish-drejtorit të Kadastrës L. P., pa dhënë argumente apo detaje se ku konsistojnë shkeljet e kryera nga subjekti i rivlerësimit, por ka cituar *“mjafton të kërkohet praktika e dhënies së kësaj mase, ku u mor vendimi në cilën zyrë të kujt gjyqtari, kush e kërkoi arrestimin e L. .”*

3.1.i Komisioni ka administruar dosjen gjyqësore me nr. ***vendimi, datë 2.2.2021, që i përket gjykimit nga subjekti i rivlerësimit të kërkesës së organit të prokurorisë ndaj 16 të pandehurve ku, ndër të tjerë, renditen edhe shtetaset A.I., F. Gj., për të cilët denoncuesja parashtron pretendimet e saj.

3.1.ii Nga aktet e dosjes rezulton se të pandehurit janë regjistruar në organin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës me procedimin penal nr. ***. Palë e këtij procesi gjyqësor janë edhe trashëgimtarët e viktimave të tërmetit të nëntorit të vitit 2019, për shkak të shembjes së godinave të legalizuara pikërisht, nga të pandehurit si ish-zyrtarë të institucioneve nga ku janë dhënë lejet përkatëse.

³³ Me shkresën nr. *** prot., datë 2.4.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

³⁴ Dërguar me e-mail në datën 2.2.2021.

3.1.iii Nga aktet e administruara rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka dërguar kërkesën për gjykim ndaj të pandehurve si ish-zyrtarë, të akuzuar për *shpërdorim detyre*, si dhe të disa të akuzuarve të tjerë, akuzuar për *falsifikim dokumentesh* dhe *ndërtim të paligjshme*, si pasojë e të cilave ka ardhur humbja e jetëve në tërmetin e nëntorit të vitit 2019.

3.1.iv Pas studimit në tërësi të dosjes objekt gjykimi, Komisionit i rezultoi se çështja penale është regjistruar në datën 24.11.2020 dhe ka përfunduar së gjykuari në datën 2.2.2021. Pra, gjykimi i çështjes ka zgjatur tre muaj e një javë, brenda afatit 6-mujor të caktuar nga germa “e”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

3.1.v Në dosje është administruar vendimi për caktimin e seancës paraprake, janë administruar rregullisht njoftimet e të pandehurve, avokatëve të tyre, kërkesat për shtyrje të seancave, mendimet e përfaqësuesve të organit të akuzës nga njëra seancë në tjetrën, lidhur me shtyrjen e tyre, arsyet e motivuara të pranimit të kërkesave nga gjykata, etj. Në tërësi nuk duket të konstatohen parregullsi të natyrës procedurale.

3.1.vi Organi i Prokurorisë i ka qëndruar kërkesës për t’u dërguar për gjykim disa të pandehurve, ku renditen edhe dy shtetasit e pretenduar nga denoncuesja se për ta janë mbajtur qëndrime të ndryshme në vendimmarrje.

3.1.vii Çështja është gjykuar në mungesë të shtetasit F.Gj., por në prezencë të mbrojtësit të tij ligjor, ndërsa shtetasi A. I. rezulton i pranishëm në vendimmarrjen e gjykatës, së bashku edhe me mbrojtësin e tij ligjor.

3.1.viii Gjykata, me vendimin e saj, ka vendosur pushimin e çështjes për të pandehurin A. I. dhe dërgimin për gjykim për të pandehurin F. Gj. . Në fakt të dy këta të pandehur janë akuzuar nën të njëjtën akuzë, “shpërdorim detyre”, si dhe të dy kanë mbajtur detyrën e drejtorit të ALUIZNI-t, por në kohë të ndryshme.

3.1.ix Subjekti i rivlerësimit ka përshkruar në arsyetim rrethanat e çështjes, akuzat përkatëse, provat mbi të cilat është bazuar, etj.

3.2 Pa zëvendësuar logjikën në arsyetimin e vendimit, Komisioni i ka kërkuar subjektit të shpjegojë duke u përqendruar në pretendimet e denoncueses, të depozitohet shkresën nr. ***, datë 17.5.2016, drejtuar Bashkisë Durrës, Zyrës së Urbanistikës, nënshkruar nga i pandehuri F. Gj.(sikurse ka cituar në arsyetimin e vendimit në pikën 112, në f. 326 të fashikullit), si dhe lejen e legalizimit, sikurse citohet se ajo ka dalë në të njëjtën datë kur dhe është bërë kërkimi pranë Bashkisë, si dhe të qartësojë mbi statusin aktual të kësaj çështjeje gjyqësore.

3.3 Subjekti, në parashtrimet e saj, ndër të tjera, ka shpjeguar në pjesën hyrëse të vendimit nr. ***, datë 2.2.2021, ndryshe nga sa ka pretenduar denoncuesja, evidentohet se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, në fazën e hetimeve paraprake, ka kërkuar për dy personat nën hetim A. I. dhe F.Gj. të njëjtën masë sigurimi “arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale. Ndaj të pandehurit A. I., masa e sigurimit është ekzekutuar menjëherë, ndërsa për të pandehurin F.Gj., masa e sigurimit është dhënë në mungesë, deri në gjetjen e tij. Për të dy të pandehurit, masa e sigurimit është zëvendësuar në vijim.

Shtetasit A. I. dhe F. Gj. janë marrë në cilësinë e të pandehurit për veprën penale “shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pasi kanë qenë në pozicionin e drejtorit të ish-ALUIZNI-t Durrës, megjithatë, praktikat e legalizimit që ata kanë ndjekur kanë qenë të ndryshme, për objekte të ndryshme dhe në kohë të ndryshme. Shtetasi A. I. ka nënshkruar lejen e legalizimit

për objektin “M***”, në Durrës, ndërsa shtetasi F. Gj. ka nënshkruar lejen e legalizimit për objektin lokal “Bar ***” në Durrës. Në cilësinë e drejtuesit të institucionit, shtetasi F. Gj. nuk duhet të kishte lejuar legalizimin e objektit, pasi ka konstatuar mangësitë, gjë të cilën e ka lejuar dhe përfunduar me nënshkrimin e lejes së legalizimit, në kundërshtim me ligjin. Për të pandehurin A. I. ka rezultuar se për mangësitë e konstatuara në procedurën e legalizimit (aktekspertimi është në fotokopje), ky i fundit nuk ka pasur përgjegjësi në kontrollin e tyre, për sa kohë kontrolli i dokumentacionit ka qenë kompetencë e punonjësve të tjerë të ALUIZNI-t, konkretisht e përgjegjësit të sektorit të legalizimeve. Rezultoi se shtetasi A. I. as nuk kishte marrë dijeni për këtë fakt, pasi vendimi i kualifikimit të objektit informal “M***” ishte nënshkruar nga përgjegjësi i sektorit të legalizimeve, rregullisht. Sipas shënimit në vendimin nr. ***, datë 2.2.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe shkresave nr. ***prot., datë 2.4.2021 dhe nr. *** prot., datë 7.4.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, rezulton se ndaj vendimit të pushimit për të pandehurit A. I. dhe A. T. është paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Durrës, ndërsa ndaj vendimit të dërgimit të çështjes për gjykim për të pandehurin F. Gj. nuk lejohet ankim. Subjekti sqaron se çështja penale në ngarkim të të pandehurit F. Gj., aktualisht, është në gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, për t’u gjykuar nga një tjetër trup gjykues.

Subjekti ka depozituar: shkresën nr. *** prot., datë 2.4.2021 dhe shkresën nr.***, datë 7.4.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; vendimin nr. ***, datë 2.2.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës (i seancës paraprake); lejen e legalizimit nr. ***, datë 17.5.2016, të ALUIZNI-t Durrës; shkresën nr. *** prot., datë 17.5.2016, të ALUIZNI-t Durrës, dalë prej shtetasit F. Gj., në cilësinë e drejtuesit të institucionit; informacionin mbi statusin aktual të çështjes; vendimin nr. ***, datë 24.9.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për caktimin e masës së sigurimit ndaj shtetases L.K. .

3.4 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të dhëna dhe dokumentacionit të depozituar, konstaton se në të njëjtën datë, 17.5.2016, në të cilën i pandehuri F. Gj., me cilësinë e drejtorit të ALUIZNI-t, ka miratuar lejen e legalizimit për familjen T., njëkohësisht edhe ka kërkuar informacion nga Bashkia e Durrësit për të konfirmuar mbi rregullsinë e ndërtimit. Pra, në këtë këndvështrim vërehet se identifikimi i provës, i pasqyruar në vendim, me të cilin është argumentuar, ndër të tjera, edhe vendimmarrja e subjektit, është i saktë. Sa i përket argumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti në parashtrimet e saj lidhur me gjykimin e kësaj çështjeje, por edhe logjikës së përdorur në arsyetim, çmohet se vendimmarrja është atribut i gjyqtarit dhe jo tagër i Komisionit. Kërkimi i provës së cituar dhe arsyetuar në vendimmarrje është një kërkesë normale për sa kohë arsyetohej por nuk vërehej në dokumentacionin e administruar. Kjo kompetencë ushtrohet nga ky trup gjykues, ndërsa çështja e themelit për mënyrën se si është vendosur nga subjekti, lidhur me kërkesat për gjykim të personave nën hetim, trajtohet dhe ligjërohet nga gjykatat e shkallëve më të larta nën ankimet e ushtruara nga palët.

3.5 Lidhur me denoncimin mbi masën e sigurisë dhënë ndaj të pandehurit L. P., Komisioni ka administruar të gjithë fashikujt penalë dhe ka kryer verifikimin përkatës.

3.5.i Nga aktet rezultoi se më 26.9.2019, prokurori A. N., prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës caktimin e masës së sigurisë “arrest me burg” në ngarkim të shtetasit L. P., për kryerje të veprës penale “shpërdorim të detyrës”, parashikuar nga nenin 348 i Kodit Penal.

3.5.ii Çështja penale ka nisur me regjistrimin e procedimit penal nr. ***, datë 22.9.2017, mbi bazë të materialeve të referuara nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës. Fokusi i shkeljeve i referohet

kryesisht disa praktikave të regjistruara në ASHK Dega Durrës, ku i akuzuari ka mbajtur detyrën e drejtorit, si dhe transaksioneve të kryera me pasuritë pjesë e dy praktikave të cilat sipas organit të akuzës kanë rezultuar mosnënshkrime në fletë të tyre si nga specialistja jurist (denoncuesja), por edhe nga drejtori L. P. apo edhe mosnënshkrime dhe mungesë vulash në regjistrat ku janë regjistruar pasuritë. Organi i akuzës ka renditur edhe shkelje të tjera të kryera, si p.sh., pranimi i aplikimeve nga shoqëria “L****” sh.p.k. për regjistrimin e pasurive, pa u administruar akti i përfaqësimit apo tagri i dhënë nga shoqëria për aplikantin apo edhe nënshkrimi i certifikatave të pasurisë nga drejtuesi i institucionit, pa u plotësuar kushtet ligjore.

3.5.iii Subjekti i rivlerësimit, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. ***, datë 1.1.2010, me kërkesë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, ndaj shtetasit L.P., si person i dyshuar për kryerjen e veprës penale “shpërdorim të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

3.5.iv Rezulton se vendimmarrja është marrë një ditë pas regjistrimit të çështjes. Në kushte të tilla nuk konstatohen problematika.

3.5.v Ndaj vendimit të sipërcituar ka ushtruar ankim përfaqësuesja ligjore e të akuzuarit. Organi i Prokurorisë në konkluzionet e tij edhe para Gjykatës së Apelit sërish ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 298, datë 18.10.2019, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke caktuar si masë sigurimi personal ndaj personit nën hetim “detyrim për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore”.

3.5.vi Ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës ka ushtruar rekurs përfaqësuesja e personin nën hetim, e cila ka kërkuar prishjen e dy vendimeve të gjykatave dhe rrëzimin e kërkesës për caktimin e masës shtrënguese në ngarkim të shtetasit L. P. .

3.5.vii Kolegji penal i kësaj gjykate, me vendimin nr. ***, datë 29.5.2020, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga personi nën hetim.

3.5.viii Në analizë për sa më sipër, ka rezultuar se çështja është gjykuar në kohë nga subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu, nga aktet e administruara në dosje nuk rezultoi të jenë kryer shkelje të natyrës procedurale nga subjekti i rivlerësimit. Trupi gjykues nuk mund të vlerësojë themelin e çështjes duke zëvendësuar logjikën e subjektit në vendimmarrje, për më tepër kur çështja ka ezauruar edhe shkallët më të larta të gjyqësorit.

Vlerësimi i çështjes në tërësi nga trupi gjykues

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, pasi dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara prej saj, çmon se:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e saj nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.
- Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, për sa është arsyetuar lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

- Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti plotëson kushtet e nenit 59/1,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Besjana Garxenaj, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 22.4.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes SHULI
Kryesuese

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Pamela QIRKO
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta